



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Shërbime Publike

PLANI PESË - VJEÇAR I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

2016 – 2021

DRAFT

Përmbajtja

1. Gjendja ekzistuese.....	4
1.1. Operatori i menaxhimit të mbeturinave.....	5
1.2. Menaxhimi i Mbeturinave.....	5
1.3. Sfidat në menaxhimin e mbeturinave të cilat nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejt të komunës.....	8
1.4. Masat aktuale për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave.....	8
1.5. Korniza kombëtare ligjore dhe politikat.....	9
1.5.1. Korniza lokale ligjore.....	10
2. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave.....	11
2.1. Fushëveprimi i planit.....	11
2.2. Synimet e përgjithshme PLMM.....	12
2.3. Caqet.....	12
2.4. Fazat e zbatimit të planit 2016-2021.....	13
2.5. Themelimi i sektorit Menaxhimit të Mbeturinave.....	14
2.6. Krijimi i sistemit financiar për menaxhimin e mbeturinave.....	17
2.7. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave.....	17
3. Plani Financiar 2016-2021.....	19
3.1. Supozimet kryesore në planin financiar.....	20
3.2. Investimet e reja të nevojshme kapitale.....	20
3.3.1. Te hyrat e sektorit të MM për vitin 2015.....	23
3.3.2. Arkëtimi i detyrimeve në sektorit të MM për vitin 2015.....	24
3.3.3. Klientët në sektorit të MM për vitin 2015.....	26
3.3.4. Trajtimi i mbeturinave për vitin 2015.....	26
4. Vlerësimi Strategjik Mjedisor.....	31
5. Ndërgjegjësimi i publikut.....	35
6. Plani i Veprimit.....	38
6.1. Qartësimi i përgjegjësi të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes lokale.....	38
6.2. Përmbledhje e Planit të Zbatimit 2016-2021.....	40
7. Monitorimi dhe rishikimi.....	42
7.1. Përcaktimi i treguesve të performancës dhe burimet e verifikimeve.....	43
Aneks I: Zoonimi i territorit.....	45
Aneks II: Njohja e zonës.....	50
Aneks III: Mbulimi i zonës me shërbime të MM.....	53
Aneks IV: Implementimi i PLMM.....	55
Aneks V: Vlerësimi i performancës financiare e operativ të sektorit të MM Komuna Rahovec.....	58

AKRONIMET / SHKURTESAT

PLMM	Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave
KRM	Kompania Regjinale e Mbeturianve
RAE	Komuniteti Romë Ashkali dhe Egjiptian
MM	Menaxhimi i Mbeturinave
KP	Kompania Publike
KK	Kuvendi Komunal
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NP	Ndërmarrja Publike

1.Gjendja ekzistuese

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka gjithsej 56.208 banorë. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa urbane, me 15.892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40.316 (71.3%) në zonat rurale.

Tabela 1: Numri i popullsisë dhe shkalla e rritjes

Viti	Total	Urbane	Rurale
2011	56,208	15,892	40,316
2012	56,854	16,075	40,780
2013	57,508	16,260	41,249
2014	58,170	16,447	41,723
2015	58,839	16,636	42,203
2016	59,515	16,827	42,688
2017	60,200	17,021	43,179
2018	60,892	17,216	43,676
2019	61,592	17,414	44,178
2020	62,300	17,615	44,686
2021	63,010	17,821	45,194

Burimi: ASK, 2011

Nga tabela 1 mund të shihet trendi i rritjes së popullsisë në Komunën e Rahovecit, ky trend nuk pritet të shenoj rritje të madhe në pesë vitet e ardhshme.

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në Komunën e Rahovecit dominon mosha e re, dhe atë si në zonën urbane njashtu dhe atë rurale. Ndërsa grupmosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjece.

Nëse bëhet një analizë më e thellë e strukturës së popullsisë në komunën e Rahovecit mund të vërehet se popullësia është e shtrirë po thuajse në mënyrë të barabartë në të gjitha zonat. Mund të shifet një numër më i madh i shtrirjes së banorëve (71.6%) në pjesën rurale të Komunës gjegjësisht në distancat nga 3-9 km. Shpjegimi rreth shtrirjes është dhënë edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Numri i popullsisë sipas grupeve:

Popullata	0-3 km	3-6 km	6-9 km	9-12 km	12-40 km	Total	Ne %
Urbane	15,892	-	-	-	-	15,892	28.3%
Para Urbane	-	4,205	-	-	-	4,205	7.5%
Rurale	-	-	7,023	14,647	-	21,670	38.6%
Rurale e Thell	-	-	-	-	14,441	14,441	25.7%
Total	15,892	4,205	7,023	14,647	14,441	56,208	100.0%

1.1.Operatori i menaxhimit te mbeturinave

Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit respektivisht nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë janë Ndermarrja Publike "Ekoregjioni"¹ me njësinë e saj "Ambienti" mbulon territorin e Rahovecit. Pjesëmarrja e komunës së Rahovecit në këtë ndërmarrje është 8%, ndërsa përveç "Ekoregjionit" në Rahovec operon edhe kompania private "Ekodrinia" e cila po ashtu një pjesë të territorit të komunës. Veprimtaria primare e operatorëve është grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale, si dhe shërbime dytësore si: menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimin e rrugëve, pastrimin e borës, si dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike.

Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve respektivisht konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet. Konsumatorët shtëpiak ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, në konsumatorë shtëpiak të cilët pranojnë shërbimin derë më derë dhe konsumatorë të pajisur me kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve dhe hiq ndonjë zyre të vogël të OJQs, avokatie apo të ngjashme zakonisht janë me kontrata të veçantë dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë.

Periudha kohore e grumbullimit të mbeturinave zakonisht zhvillohet nga ora 07:00 – 14:00.

Për procedurën dhe metodologjinë e caktimit të tarifave, kompania ka aplikuar tarifat që kanë qenë sipas modelit të ZRRUM-it (2006), të ndryshuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në Qershor të vitit 2012, të cilat ende janë në fuqi. Mekanizmi i inkasimit për momentin në amvisëri dhe biznese të vogla bëhet përmes Inkasantëve dhe arkës ndihmëse, por ka raste që bëhet edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse nga konsumatori. Kurse tek bizneset e mëdha dhe institucionet, inkasimi bëhet përmes arkës dhe llogarive rrjedhëse.

Numri total i klientëve të kompanisë "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" dhe "Ekodrinia" për vitin 2015 dhe përditësimet e fundit në Shtator të vitit 2016, ka qenë rreth 9130 dhe kjo ka ndryshuar nga muaji në muaj sipas arkëtimeve:

Shtirja zonale e amvisërive dhe bizneseve (klient) të cilat janë të përfshira në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia" janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3072 klient
- Zona Rurale : zonat e mbetura të rrethinës – 6064 klient

NJP "Ambienti" ka të punësuar gjithsej 41 punonjës. Kompania tjetër "Ekodrinia" ka 9 punëtor.

Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët dërgohen për deponim final në deponinë sanitare në Landovicë që menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) – Prishtinë. Pagesa për deponimin permanent bëhet tek Deponia Sanitare në Landovicë, ku edhe bëhet matja përkatëse.

Kapaciteti ruajtës i mbeturinave me kontejnerët ekzistues është rreth 25 ton. NJP "Ambienti" posedon 5 kamion kompaktorë, 1 kamion me cisternë, 1 kamion me rimorkio, 3 traktorë.

"Ekodrinia" posedon 3 kamiona 12, 11 dhe 6 tonesh, një kamionetë dhe një cisternë 15000 L.

1.2.Menaxhimi i Mbeturinave

¹ E cila operon në: Prizren, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Dragash

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prap se prap haset në deponi ilegale si dhe hudhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe "hot-spotet" (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçant në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat i botuar më 2014, i cili është përgatitë nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit i Kosovës (AMMK), Komuna e Rahovecit cilësohet të ketë ndikim prej 3-5ha të hapësirës komunale të mbuluar me deponi ilegale.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mospagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e ndarjes dhe riciklimit.

Aktualisht operatori me i madh është NJP "Ambienti" e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Kurse operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.

Mbeturinat Ndërtimore/demolimet: si rezultat i mosekzistimit të deponise adekuate për këtë kategori të mbeturinave, mbetjet nga materialet ndërtimore dhe demolimet për shkak të hidhen gjithandej duke renduar aspektet mjedisore dhe estetike. Shpesh hedhja e pakontrolluar e këtyre mjeteve shkatërron krijimin e deponive të egra dhe hudhjen e mbeturinave të ndryshme nga ana e banorëve dhe bizneseve. Përpos kësaj nuk ekziston lidhja në mes të dhënies së lejeve ndërtimore dhe sistemit të monitorimit të hudhjes së mbeturinave. Sa i përket deponisë së inerteve Komuna është në procesin e përzgjedhjes së lokacionit të duhur. Projekti i ndërtimit të deponisë së inerteve është i përfshirë në listën e projekteve që parashihen të realizohen në Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ku parashihet bashkëfinancimi 40% donatori; 30% Buxheti i Kosovës; dhe 30% Komuna e Rahovecit.

Mbeturinat nga Mbetjet Shtazore: Menaxhimi i mbetjeve shtazore në Komunën e Rahovecit nuk është në harmoni me dispozitat respektive, në rendë të parë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve shtazore. Në Komunë ekzistojnë 8 subjekte që merren me prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit prej tyre 3 mishtore dhe 5 thetore. Me disa prej tyre operatori aktual ka kontratë të shërbimit dhe i grumbullon mbeturinat, ndërsa një pjesë e subjekteve i hedh këto mbeturina në formë ilegale. Për më shume, edhe mbeturinat me prejardhje shtazore që grumbullohen nga ana e operatorit të licencuar nuk është e qartë si trajtohen meqë deponia regjionale nuk pranon që ky lloj mbeturinave të deponohet në këto lokacione të veçanta.

Strategjia dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave, parashohin financimin e ndërtimit të impiantit të mbetjeve shtazore, i cili do të parashihte rregullimin e menaxhimit të mbetjeve të kësaj natyre në nivel të Kosovës përfshi këtu edhe Komunën e Rahovecit.

Realizimi i këtyre projekteve që parashihet të realizohet në periudhën projektuese do të kontribuonte në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

Vlenë të theksohet se një deponi e tillë është duke u ndertuar dhe financuar nga zyra e BE-së në Kosovë, ku do të ketë për qëllim, grumbullimin e të gjitha mbetjeve të kafshëve nga i gjithë territori i Kosovës.

Me ndërtimin e kësaj deponie, do të përfitoj edhe Komuna e Rahovecit, ku do ti obligoj banorët/aktivitetet të cilat merren me këtë aktivitet ti deponojnë këto mbetje në deponinë adekuate dhe jo në deponi të egra.

Sa i përket mbetjeve të rrezikshme, në Komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë aktivitet që do të kontribuonte substancialisht në ngritjen e ndikimit në mjedis nga këto mbetje. Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme përfshi këtu mbeturinat kimike-industriale dhe ato medicinale do të kontribonte në përmirësimin e mjedisit dhe minimizimin e mundësisë së kontaminimit të mbeturinave komunale tokës dhe burimeve ujore nëntokësore. Largimi efektiv i mbeturinave ndërtimore dhe mbetjeve shtazore do të rezultonte në lirim të ngarkesës për operatorët që grumbullojnë dhe bartin mbeturinat komunale. Poashtu menaxhimi i tyre i duhur, do evitonte shkakun për hapjen e deponive të egra siq po ndodhë në periudhën e tanishme.

1.3.Sfidat në menaxhimin e mbeturinave të cilat nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejt të komunës

Përveç mbeturinave të zakonshme të amvisërise dhe bizneseve cilat janë në kuadër të kompetencave të komunës, ekzistojnë edhe një kategori e konsiderueshme e mbeturinave të cilat deponohen në territorin e komunës dhe që nuk janë kompetencë e drejtpërdrejtë e saj.

Mbeturinat Kimike-Industriale: Komuna e Rahovecit nuk ka ndonjë deponi në territorin e saj të identifikuar si "deponi" me mbeturina kimike-industriale me sasinë e deponuar që tejkalojnë 5 ton për deponi, sipas raportit për "Hotspote" i publikuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Mbeturinat Medicinale: Në komunën e Rahovecit ekziston 1 qendër të mjekësisë familjare dhe 10 ambulanta/klinika, këto qendra duhet që normalisht ti trajtonin ndaras mbeturinat medicinale duke pasur parasysh efektin negativ në mjedis dhe shëndet. Këto mbeturina duhet të trajtoheshin përmes incineratorëve të instaluar në spitalet rajonale, ku pika më e afërt e Komunës së Rahovecit për trajtimin e këtyre mbetjeve është spitali i Prizrenit por që incineratori nuk është duke punuar për momentin gjë që bën që këto mbetje të hidhen në kontejner komunal duke kontaminuar më tutje edhe mbeturinat komunale. Në anën tjetër sipas intervistimit me stafin mjekësor të këtyre qendrave, thuhet se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme medicinale është tejet i vogël duke pasur parasysh që rastet e shumta që kërkojnë trajtim spitalor dërgohen në spitalet rajonale si ai i Gjakovës apo Prizrenit.

Mbeturinat elektronike: Si në të gjithë territorin e Kosovës, ashtu edhe në Komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë trajtim të vecant të këtyre mbeturinave, edhe pse nuk janë në kompetencë të komunës.

1.4.Masat aktuale për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave

Masat e parandalimit të gjenerimit të mbeturinave janë në nivele modeste në rastin më të mirë dhe pa efekt në reduktimin e sasisë së gjenerimit të mbeturinave. Poashtu Komuna nuk ka ingerenca në menaxhimin e rrjedhave të tjera të mbeturinave nga ato të ngurta komunale.

Hudhja ilegale: Një pjesë e mbeturinave përfundon në deponitë ilegale të cilat sipas vlerësimeve në terren të zbatuar janë identifikuar lokacionet e hedhjeve ilegale të mbeturinave. Komuna e Rahovecit disa herë ka marrë iniciativë në rehabilitimin e këtyre deponive në nivel sipërfaqësor. Lloji i mbeturinave që gjendet në këto pika të egra janë kryesisht mbetje komunale dhe inerte, por mund të gjenden edhe mbetje me origjinë nga kopshtet, mbetjet shtazore, gomat e vjetruara, pajisje elektroshtëpiake mbeturinë, etj.

1.5. Korniza kombëtare ligjore dhe politikat

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovë rregullohet përmes Kornizës Ligjore e cila është e harmonizuar me legjislacionin evropian respektivisht direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat rregullojnë sektorin e mbeturinave. Qëllimi kryesor i kornizës ligjore për menaxhimin e mbeturinave është evitimi dhe reduktimi në masë sa më të madhe të mundshme të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Korniza ligjore përbëhet prej ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Ligji kryesor i cili në mënyrë të detajuar rregullon menaxhimin e mbeturinave është Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina. Ky ligj përcakton dhe rregullon planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave; kushtet për grumbullimin e mbeturinave, transportin, trajtimin, magazinimin dhe asgjësimin, llojet dhe klasifikimin e mbeturinave, përgjegjësitë e personave juridik dhe fizik lidhur me menaxhimin e mbeturinave, kushtet dhe procedurat e licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave, ndëshkimet për mosrespektimin e dispozitave ligjore si dhe çështjet tjera lidhur me mbeturinat. Neni 14 dhe 15 i Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, përcakton përgjegjësit për menaxhimin e mbeturinave të institucioneve të nivelit qendror dhe nivelit lokal. Me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, komuna marr përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave.

Përveç ligjeve të lartpërmendura Korniza Ligjore për menaxhimin e mbeturinave përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera dhe sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave, siç janë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të plotë dhe ekskluzive të komunave. Në bazë kësaj kompetence komunat kanë autorizim ligjor të krijojnë struktura, mekanizma si dhe të parashohin buxhet të veçantë me qëllim të menaxhimit sa më të mirë dhe efikas të sektorit të mbeturinave.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton dhe rregullon pronësinë e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen e korporative të tyre në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Neni 6 i Ligji Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike mundëson krijimin e ndërmarrjeve publike lokale nga komunat. Ndërsa me nenet 4, 5, 6 të Rregullores Nr.02/2013 përcaktohen kriteret dhe procedurat për krijimin e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave. Në bazë të nenit 5.2 të këtij ligji të drejtën e komunës si aksionar e ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga: një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

1.5.1. Korniza lokale ligjore

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe ligjet tjera sektoriale, komuna është e obliguar të krijoj kornizën lokale ligjore me qëllim të menaxhimit sa më efikas të mbeturinave në territorin e tyre. Kornizat lokale përbëhen nga rregulloret komunale, udhëzimet, politikat, rregullatorë të ndryshëm, dhe vendimet që rregullojnë sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të kornizës lokale ligjore, komuna ka miratuar:

- Rregulloren për plotësimin e rregullorës për Menaxhimin e Mbeturinave 01 Nr.4103 të datës 09.12.2015,
- Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit.01.Nr.239 të datës 30.01.2015 si dhe
- Rregulloren për Shërbime Publike dhe Emergjencë 01.Nr.1676 të datës 30.03.2012

Më qëllim të plotësimit të kornizës lokale ligjore dhe përmirësimit të saj, do të miratohet:

- Rregullorja për funksionimin e sektorit kompetent komunal dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave,
- Rregullorja për financimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve financiare për aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave,

2. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave

2.1. Fushëveprimi i planit

Plani Lokal për Menaxhim të Mbeturinave paraqet dokument me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Në të cilin do të definohen drejtimet dhe prioritetet, si dhe dinamika dhe mënyra e zgjidhjes së problemeve në harmoni me legjislaturën pozitive kombëtare dhe të BE-së në aspektin e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit në tërësi. PLMM përveç se është detyrim ligjor, ka për cak gjetjen dhe zbatimin alternativave më të mira për menaxhim të mbeturinave.

Caku i punimit të Planit është vendosja e sistemit të qëndrueshëm afatgjatë në menaxhimin e mbeturinave në nivel të Komunës, në mënyrë që të përmirësoj cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimit racional të burimeve dhe respektimin e parimeve moderne në menaxhimin e mbeturinave, me pjesëmarrje të koordinuar të gjitha akteve të menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të PLMM do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese për trajtimin e mbeturinave, po ashtu do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, në bazë të cilave do të shqyrtohet nevoja për zhvillime të mëtutjeshme. Synim tjetër i rëndësishëm i PLMM është që të adresoj shumë ceshtje të hapura të cilat determinojnë vendosjen e një sistemi tërësisht të ri në menaxhim të mbeturinave, i cili bazohet sipas sygjërimeve që jep Strategjia Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, Ligji për Mbeturina, Standardet Europiane dhe masat ligjore që prekin këtë fushë.

2.2.Synimet e përgjithshme PLMM

PLMM paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Rahovecit është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar objektiva specifike që janë pjesë integrale e këtij plani. Ato përfshijnë shtrirjen e shërbimeve, parandalimin, minimizimin dhe riciklimin e mbeturinave si dhe eliminimin e hudhjes së mbeturinave në hotspote apo deponi ilegale, por në vendin e përcaktuar. Objektivat janë të ndarë në dy etapa respektivisht në periudhën 2016-2018 dhe 2018-2021.

Komuna synon që përmes planit të menaxhimit të mbeturinave të arrijë:

- Vendbanime të pastra, mjedise të shëndetshme për banorët,
- Promovimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të trajtimit të mbeturinave,
- Përfshirja me shërbim të tërë zonës përmes tarifës së përballueshme si dhe rritje të inkasimit,
- Të definohen caqet e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal në harmoni me legjislaturën kombëtare,
- Të definohet sistemi optimal i menaxhimit të mbeturinave,
- Të definohen investimet e përgjithshme financiare dhe investimet në pjesët prioritare të planit të cilat duhet menjëherë të zbatohen.

Objektivat

1. *Vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina,*
2. *Krijimi i sistemit financiar për MM-në*
3. *Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave*
4. *Promovimi i minimizimit të mbeturinave përfshirë mbylljen e deponive ilegale*
5. *Përkrahje për ri-organizimin e komunitetit*
6. *Zhvillimin e pilot projekteve me qëllim të realizimit të 3R-konceptit (Reciklim, Reduktim dhe Ripërdorim)*

2.3.Caqet

Plani synon të menaxhojë me mbeturinat nga ekonomitë familjare (amvisërit dhe nga bizneset afariste), dhe mbeturinat komunale.

- Shkalla e mbuluesmërisë së shërbimit të grumbullimit do të thotë shkalla e popullsisë së shërbyer me popullsinë e përgjithshme.
- Shkalla e grumbullimit do të thotë shkalla e sasisë së mbeturinave të grumbulluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.
- Shkalla e hedhjes ilegale do të thotë shkalla e mbeturinave të hedhura ilegalisht duke përfshirë hedhjen jo të duhur brenda zonës pa shërbim me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e deponimit final do të thotë shkalla e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara dhe ato të palicencuara (hudhja ilegale) me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e riciklimit do të thotë sasia e mbeturinave të ricikluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.

Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura në tabelen e mesipërme janë hartuar duke u bazuar në të dhënat e grupit punues, si dhe përmes modelit kompjuterik, që shërben që të bëhen supozime për periudhat e ndryshme duke matur trendet paraprake.

2.4. Fazat e zbatimit të planit 2016-2021

Vizioni i lartpërmendur do të arrihet hap pas hapi. Viti i synuar i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Rahovecit, është prej 2016 deri 2021. Kjo periudhë ndahet në dy faza, si më poshtë.

Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave 2016-2021 është i bazuar në dy faza :

- Faza e 1 të : 2016 – 2018 - Krijimi i një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave, që nënkupton se brenda kësaj periudhe kohore do të krijohet sektori i menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që të krijohet data baza e të dhënave, e cila do të shërbente për një menaxhim efikas rreth mbeturinave dhe po ashtu mundësia që të realizohet inkasimi për mbeturina në Komunë.
- Faza e 2 të : 2018 – 2021 - Krijimi i sistemit të ri të grumbullimit, që nënkupton se gjatë kësaj periudhe synohet të arrihet sistemi i ri i grumbullimit të mbeturinave duke analizuar dhe vlerësuar gjendjen aktuale të resurseve humane dhe pajisjeve për arsye se do të rritet niveli i shërbimit në mënyrë që të rritet edhe niveli i inkasimit.

Duke u bazuar në synimet e ndara në këto dy faza , plani pesë vjeçar i MM mund të modifikohet deri në fund të vitit 2018, bazuar në progresin e performancës aktuale në fazën e parë.

Realizimi i planit në periudhën e planifikuar do të modifikohet, monitorohet e të përshtatet në fund të vitit 2018 bazuar në arritjet e rezultateve të përcaktuara në fazën e parë.


2.5.Themelimi i sektorit Menaxhimit të Mbeturinave

Komuna do të themeloj Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave pjesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, do të përcaktoj mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare dhe caktimin e tarifave,do të shikoj mundësinë për të krijuar një në qendër profiti (riciklimi). Për të realizuar planin për MM, Komuna e Rahovecit fuqizon Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave të themeluar brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike e cila do ti ketë këto përgjegjësi :

- Do të bëjë në bashkëpunim me akterët gjegjës për zbatimin e planit për menaxhim të mbeturinave,
- Do të përpiloj në bashkëpunim me akterët gjegjës planet operative për grumbullimin dhe trajtim të mbeturinave, duke i caktuar dhe rishikuar zonat e operimit ,
- Do të përpiloj në bashkëpunim me akterët gjegjës planin për inkasimin e mjeteve financiare,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës,do të caktoj kushtet dhe kriteret speciale për operatorët që do të merren me grumbullim, transportim dhe trajtim të mbeturinave si dhe do të organizoj monitorimin dhe vlerësimin e këtyre kompanive,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloi procedura dhe aktivitete për monitorim të aktiviteteve që zvoglojnë sasinë e hudhjeve ilegale, të zhvilloj dhe menaxhoj planet për eliminim të pikave me mbeturina ilegale,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloj pilot projekte që kanë për qëllim përmirësimin e performancës së Komunës në lëminë e menaxhimit të mbeturinave,
- Gjatë vitit 2017, komuna përmes procesit të tenderimit do të bëj përzgjedhjen e operatorit për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave në zonat e përcaktuara nga komuna.

Zonat e shërbimit

Fig 1. Ndarja zonale e komunes së Rahovecit



Zonimi i territorit të Komunës së Rahovecit për qëllime të menaxhimit të mbeturinave
Për qëllime të organizimit të menaxhimit të mbeturinave është krijuar sistemi i zonimit të territorit.
Zonimi i territorit është bazuar në kriteret :

- Shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit të ne menaxhimit të mbeturinave
- Shpërndarja në bazë të numrit të banorëve
- Shpërndarja në bazë të numrit të amvisërive
- Shpërndarja në bazë të numrit të objekteve

Zona e synuar për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave është e gjithë zona administrative e Komunës së Rahovecit. Zona që synohet të arrihet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë disa familje të fshatrave të zonës së 2 (ngjyra e hapur) ku synohet të futen në sistem edhe 533 ekonomi familjare shtesë ku deri tash në një mënyrë apo tjetrën nuk kanë qenë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, detajet e fshatrave dhe gjenerimit të mbeturinave mund të shihen në tabelën e mëposhtme së bashku me synimin për mbulueshmëri gjatë implementimit të këtij plani :

Tabela 3: Lokalitetet të cilat nuk marrin shërbim të plotë të MM

Lokalitetit	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Ekonomi Famil.	Ekonomi Famil./Te Mbulura	Ekonomi Famil./Pa Mbulura	Gjen.Mbet.ne Vit-Ton	Mbet. Jo-te. Menaxh.
Nushpal	Zona 2	7	6-9	32	22	10	40	13
Senoc	Zona 2	7	6-9	101	69	32	125	39
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	162	60	102	147	93
Gexhë	Zona 2	12	9-12	165	68	97	120	71
Kaznik	Zona 2	13	12-40	24	8	16	24	16
Bratotin	Zona 2	21	12-40	58	24	34	58	34
Dabidol	Zona 2	21	12-40	138	36	102	117	86
Sarosh	Zona 2	23	12-40	2	1	1	1	0
Petkoviq	Zona 2	28	12-40	183	56	127	107	74
Mrasor	Zona 2	32	12-40	28	15	13	28	13
Total				892	359	533		439

Pra synohet që të rritet mbulueshmëria për fshatrat e kësaj zonë dhe të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe 439 ton mbeturina vjetore, sic edhe mund të shifet nga tabela e mëposhtme.

Tabela 4: Implementimi i MM -Kategorit kryesore per periudhen 2016-2021

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomit Familiare	-	393	140	-	-	-	533
Nr.Lokalitetet	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banoreve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara(Ne TON)	-	352	87	-	-	-	439

Tabela 5.:Iplemetimi I MM -Ekonomite Familiare

Zona	Viti/Iplemetim	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Nushpal	2017		10					10
Senoc	2017		32					32
Polluzhë	2017		102					102
Gexhë	2017		97					97
Kaznik	2017		16					16
Bratotin	2017		34					34
Dabidol	2017		102					102
Sarosh	2017		1					1
Petkoviq	2018			127				127
Mrasor	2018			13				13
Total		-	393	140	-	-		533
Lokalitetet		-	8	2	-	-		10

2.6. Krijimi i sistemit financiar për menaxhimin e mbeturinave

Në mënyrë që pritjet të jenë të kënaqshme për të hyrat nga taksa dhe tarifat për mbeturina që është planifikuar të prezantohet nga fund viti i 2016, është shumë i rëndësishëm themelimi i një sistemi të mirëfilltë të menaxhimit të mbeturinave, për këtë arsye Komuna e Rahovecit duhet të bëjë aktivitetet e planifikimeve buxhetore. Këto planifikime do të përfshijnë formimin e vijës buxhetore për realizimin e të hyrave nga taksa dhe tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, si dhe vijat buxhetore për realizimin e kontraktimit të shërbimit për menaxhim të mbeturinave. Në anën tjetër, menaxhimi i takës së grumbulluar është shumë i rëndësishëm edhe me këtë do të krijohet një sistem financiar i operuar lehtësisht në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave. Për krijimin e një sistemi financiar duhet që komuna të pajiset me softwer i cili do të jetë në kuadër të Shërbimeve Publike, por i ndërlidhur edhe me Drejtorinë e Financave.

Deri në implementimin e plotë të ligjeve në fuqi në periudhën afatshkurtër – gjatë vitit 2017-2018, Komuna përmes thirrjeve publike do të kontrakttoj operatorët për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave me të drejtë inkasimi të tarifës së shërbimit në zonat e paracaktuara për aktivitet të grumbullimit për periudhën afatshkurtër që është sipas zonave të paraqitura në tabela.

2.7. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave

Komuna e Rahovecit brenda periudhës 2017-2021 planifikon të menaxhoj me mbeturinat komunale/të ngurta konform Ligjit mbi Mbeturinat, prandaj gjatë kësaj periudhe Komuna e Rahovecit do të sigurojë buxhetin e nevojshëm përmes takës për mbeturina e cila do të mblidhet nga banorët dhe bizneset e vogla të cilat shkarkojnë mbeturinat e tyre bashkë me mbeturinat e amvisërisë dhe në mënyrë të drejtë do t'ua besojë këtë kompanive për grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale, të licencuara nga MMPH. Një menaxhim i tillë i mbeturinave, duke bërë inkasimin nga banorët për momentin nuk e ka të mundur komuna, por në rast se nuk lejohet kodi i vecantë nga Ministria e Financave, problem ky i njejtë edhe në komunat tjera, atëherë mënyra e vetme, është që të vazhdohet me sistemin aktual, ku kompanitë publike/private e bëjnë inkasimin, për shërbimin që e japin.

Prandaj, Komuna e Rahovecit është në kërkim të modusit që të shfuqizoj sistemin aktual të grumbullimit të mbeturinave, duke bërë një planifikim që operatorët të bëjnë kontraktimin në bazë

të zonave, në mënyrë që i gjithë territori i komunës të mbulohet me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave duke përfshirë edhe pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit.

Ndarja e zonave do të bëhet duke u munduar që sa më shumë të jetë një ndarje e barabartë në mes operatorëve. Komuna së bashku me kompanitë e menaxhimit të mbeturinave është dakorduar që mbledhja e mbeturinave në komunë të ndahet në dy zona, ku në kapitujt e ardhshëm do të flitet më në detaje.

REF

3. Plani Financiar 2016-2021

Planin financiar për periudhën 2016-2021 është i bazuar në gjendje aktuale të mjedisit, organizimit aktual të ndikimit të gjendjes sociale dhe faktorëve të mundësive financiare në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit.

Për krijimin e planit financiar 2016-2021 janë shfrytëzuar burimet e informacionit të kompanisë Publike Ekoregjioni-NJP "Ambienti" si dhe asaj private "Ekodrinia" për shënimet operative si dhe informatat financiare të vitit 2015.

Për njohjen e veçorive të zonës janë shfrytëzuar informatat nga regjistrimi i popullatës (cenzusi i fundit) i cili ka shërbyer për njohjen e zonës dhe shtrirjen e ekonomive familjare. Bazuar në informatat e përpunuara është krijuar sistemi për përllogaritjen e mbeturinave, shtrirjes së popullatës, dendësisë së popullatës.

Në bazë të matjeve të largësive, shtrirjes së ekonomive familjare është krijuar metodologjia e vlerësimit të mbulimit të popullatës me shërbime të menaxhimit të mbetjeve në njërin anë si dhe përllogaritja e mbeturinave të bazuar në kategori të vendbanimeve në anën tjetër. Gjenerimi i mbeturinave është i bazuar në llojet e lokaliteteve të cilat gjenerojnë mbeturina të ndryshme si për sasi ashtu edhe për përmbajtjen e tyre, të cilat kanë edhe efektet financiare të menaxhimit të mbeturinave në varëshmëri nga largësitë e përllogaritura të cilat shprehen në kostot financiare të menaxhimit të mbeturinave. Për nevoja të përpilimit të PLMM lokalitetet janë të ndara në katër kategori të mëposhtme të vendbanimeve.

- Urbane
- Para Urbane
- Rurale
- Rurale e Thellë

Projektimi i sasisë së mbeturinave të gjeneruara është i bazuar në modelin e përllogaritjes së mbeturinave i bazuar në mbeturinat e gjeneruara ditore për një person në varëshmëri prej llojit të vendbanimeve :

- Urbane 0.62² kg
- Para Urbane 0.62 kg
- Rurale 0.50 kg
- Rurale e Thellë 0.40 kg

² Përllogaritja e gjenerimit të mbeturinave ditore për person bazohet në Strategjinë Kombëtare të MM e aprovuar nga MMPH të përshtatura varësisht nga llojet e vendbanimeve (urbane, para-urbane, rurale)

3.1. Supozimet kryesore në planin financiar

Për planin financiar të Menaxhimit të Mbetjeve janë të nevojshme disa supozime të bazuara në gjendjen e vështuar në sektorin e menaxhimit të mbeturinave si dhe në rezultatet financiare të vitit 2015/2016. Supozimet janë të bazuara në objektivat e Komunës së Rahovecit për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë dhe biznese duke mos marrë në konsideratë format e reja të mundshme të operatorëve të tjerë ekonomik në menaxhimin e mbeturinave

Supozimet kryesore të planit financiar janë :

- Kompania Publike "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" edhe ajo private "Ekodrinia" për vitet afariste 2015/2016 kanë afarizëm pozitiv,
- Kompanitë të cilat operojnë në sektorin e MM shënon rritje të bazës së klientëve, normës së arkëtimit, rritje të sasive të mbeturinave të mbledhura
- Investimet do të ndodhin në bazë të nevojave afatshkurta si dhe investimet kapitale për të përmbushur objektivat e përcaktuara nga Komuna Rahovecit.
- Financimi i investimeve do të bëhet nga gjenerimi i të hyrave si dhe e nga buxheti i komunës. Burimet e mbështetjes së investimeve janë supozuar të jenë të arritshme në bazë të investimeve të planifikuara
- Kostot e menaxhimit të mbeturinave do të reduktohen si rezultat i investimeve të reja, modernizimit të mjeteve, planifikimit të orareve dhe marshutës, si dhe qasjes bashkëkohore në fushën e menaxhimit të mbeturinave.
- Norma e arkëtimit planifikohet të shënoj rritje në të gjitha kategoritë e klientëve (amvisëritë, bizneset e vogla ,bizneset e mëdha e institucionet) në norma të arsyeshme.
- Shkalla e mbledhjes së mbeturinave të gjeneruara pritet të shënoj rritje përgjatë periudhës së planifikimit

Tabela 6:Përfshirja e ekonomive familjare në sistemin e MM për periudhën 2016-2021(ekonomitë familjare të mbuluara me shërbime gjatë vitit 2015)

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomitë Familjare	-	393	140	-	-	-	533
Nr.Lokalitetet	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banoreve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara(në ton)	-	352	87	-	-	-	439

3.2. Investimet e reja të nevojshme kapitale

Investimet e planifikuara janë të bazuara në katër lloje të investimeve të cilat janë të identifikuar si të nevojshme për realizimin e objektivave afatgjatë në sektorin e MM dhe këto janë:

- Pajisje për MM
- Mjetet e transportit dhe garazhi
- Ndërgjegjësimi i publikut
- Ndarja e mbeturinave

Sektori i MM ka shtrirje të mirë të shërbimeve në përqindje 93 % të ekonomive familjare të cilat janë të mbuluara me shërbime, pajisja e operatorëve me mjete për menaxhimin e mbeturinave është në nivele të arsyeshme, nuk ka ndonjë nevojë të veçantë për investime kapitale në mjete.

Kompania "Ekoregjioni" operon në lokacion jo adekuat për zhvillimin e veprimtarisë e cila nuk i përmbush kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit, si pasojë është nevoja për dislokimi të garazheve dhe administratës në një lokacion të përshtatshëm për mbarrëvajtje të aktivitetit.

Investimet në pajisje për MM: janë të bazuara në nevojat e zëvendësimit të kontejnerëve të amortizuar si dhe mbulimin e pikave të reja me kontejner të rinjë, investimet në kontejner për amvisëritë të cilat nuk janë në sistemin e MM të planifikuara të përfshihen në sistemin e MM. Vlera investimeve në këtë kategori për periudhën e planit 5 vjeçar është 35.000 EURO e shprehur në pjesëmarrje nga totali i investimeve marrin pjesë me 26.0%

Mjetet e transportit e garazhi: janë investimet në dislokimin e garazheve e administratës në lokacion të përshtatshëm për operim. Investimet përbëhen nga kostot investive të punëve infrastrukturore e ndërtimore. Vlera investimeve në këtë kategori për periudhën e planit është 14.400 EURO e shprehur në pjesëmarrje nga totali i investimeve, bënë pjesë me 10.7%

Ndërgjegjësimi i Publikut: janë investimet të cilat janë të planifikuara për rritjen e vetëdijesimit për ruajtjen e pastërtisë dhe ambientin në formë të ndryshme përmes aktiviteteve promovionale për grupe të ndryshme të qytetarëve. Vlera e investimeve në këtë kategori për periudhën e planit është 35.000 EURO e shprehur në pjesëmarrje nga totali i investimeve, bënë pjesë me 26.0%.

Ndarja e mbeturinave: janë investime nga buxheti komunal në mënyrë që të mundësoj mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave. Investimet janë të orientuara në krijimin e kushteve në ndarjen e mbeturinave në burim. Vlera e investimeve në këtë kategori për periudhën e planit është 50.000 EURO e shprehur në pjesëmarrje nga totali i investimeve, bënë pjesë me 37.2%.


Kjo kategori e investimeve është me interes të veçantë :

- duke mundësuar ofrimin e një kategorie të re të shërbimeve të cilat nuk janë ofruar
- ndikimi i posaçëm në ambientin në përgjithësi
- zvogëlimin e kostove për menaxhimin e mbeturinave për sasinë e mbetjeve të reciklueshme (mbledhja, deponimi, transporti etj.)
- ofrimi i mundësive për kategoritë sociale të rrezikuara për gjenerimin e të hyrave për mbijetesë

Tabela 7: Investimet e bazuar në kategori kryesore për periudhën 2016-2021

Nr	Kategoria	2017	2018	2019	2020	2021	Total	Ne %
I.	Pajisje për MM	-	35,000	-	-	-	35,000	26.0%
II.	Garazhi	-	8,600	5,800	-	-	14,400	10.7%
III.	Ndërgjegjësimi i Publikut	7,000	7,000	7,000	7,000	7,000	35,000	26.0%
IV	Ndarja e mbeturinave	-	20,000	20,000	10,000	-	50,000	37.2%
	Total: Investimet	7,000	70,600	32,800	17,000	7,000	134,400	100.0%
	Ne %	5.21%	52.53%	24.40%	12.65%	5.21%	100.00%	

Grafiku 2:Investimet për periudhën 2016-2021



Investimet e planifikuara janë në varshemëri prej kohës dhe vlerës së investimeve, të cilat janë të ndara në dy periudha investive

- Periudha 2017/2018 në vlerë prej 77.600 EURO e shprehur në përqindje 57.74% prej otal investimeve të përgjithshme .
- Periudha 2019/2021 në vlerë prej 56.800 EURO e shprehur në përqindje 42.26% prej total investimeve të përgjithshme

Tabela 8:Investimet e bazuara në dy periudha investive –për periudhën 2016-2021

Nr	Kategoria	2017/2018	2019/2021	Total	Ne %
I.	Pajisje për MM	35,000	-	35,000	26.0%
II.	Mjetet e Transportit /Garazhi	8,600	5,800	14,400	10.7%
III.	Ndërgjegjësimi i Publikut	14,000	21,000	35,000	26.0%
IV.	Ndarja e mbeturinave	20,000	30,000	50,000	37.2%
Total:Investimet		77,600	56,800	134,400	100.0%
Ne %		57.74%	42.26%	100.00%	

Investimet do të mundësojnë arritjen e objektivave të përcaktuara me strategjinë e Komunës së Rahovecit në menaxhimin e mbeturinave dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve, po ashtu edhe ndikim të drejtpërdrejt në kostot e përgjithshme duke i reduktuar, bazuar në mjete të reja të cilat e risin efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave.

3.3. Analiza financiare e sektorit të MM për vitin 2016


Sektori i MM është i bazuar në shërbimet e ofruara nga dy kompani të cilat e mbulojnë zonën me shërbime me përqindje 93.5% nga numri i përgjithshëm i amvisërive të komunës. Numri i klientëve të përfshirë në sistemin e MM janë 7.697 amvisëri. Komuna e Rahovecit bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë përbëhet nga 8.230 amvisëri të regjistruara me numër të popullsisë prej 56.208 banorë. Përqindja e mbulimit me shërbime të MM janë 7.697 ekonomi familjare, e shprehur në përqindje 93.5% nga numri i përgjithshëm i amvisërive, jashtë sistemit të MM janë 533 amvisëri e shprehur në përqindje prej 6.5% nga numri i përgjithshëm i amvisërive.

3.3.1. Te hyrat e sektorit të MM për vitin 2015

Te hyrat e sektorit të MM për vitin 2015 janë në vlerë prej 354.486. Pjesëmarrja në tregun e shërbimeve të MM është i ndarë në mes dy operatoreve në pjesëmarrje jo të balancuar Operatori "Ekorregjioni"-NJP "Ambienti" merr pjesë me 63.4%(224.838 Euro) ndërsa "Ekodrinia" 36.6% (129.648 Euro)

Tabela 9: Të hyrat e sektorit të MM për vitin 2015

Kompanitë MM	Total	Ne %
NJP "Ambienti"	224,838	63.4%
Ekodrinia	129,648	36.6%
Total	354,486	100.0%




Te hyrat e sektorit për vitin 2015 kanë lëkundje sezonale në varëshmeri prej ndikimit të zonës nga migrimet në sezonin verës prej rritjes së numrit të banorëve nga diaspora. Përvoja e vendit se në periudhën e verës qershor-shtator ka rritje e gjenerimit të mbeturinave të amvisërisë e shprehur në përqindje 15%-20% nga mesatarja vjetore e gjenerimit si dhe mbledhjes së mbeturinave e cila si ndikim ka rritjen e të hyrave e arkëtimit të detyrimeve prej ofrimit të shërbimit të MM. Rritja e të hyrave është e shprehur te operatori "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" ndërsa operatori "Ekodrinia" ka raportuar të hyra të pandryshueshme.

Tabela 9: Të hyrat e sektorit të MM për vitin 2015

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejtë
NJP "Ambienti"	18,128	17,875	18,140	18,190	18,375	18,835	19,465	19,703	19,442	18,703	19,227	18,755	224,838
Ekodrinia	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	10,804	129,648
Total Sektori	28,932	28,679	28,944	28,994	29,179	29,639	30,269	30,507	30,246	29,507	30,031	29,559	354,486

Graf 3: të hyrat e sektorit MM për vitin 2015




3.3.2. Arkëtimi i detyrimeve në sektorit të MM për vitin 2015

Arkëtimi i të hyrave në sektorin e MM është indikator përcaktues i performances financiare e cila ndikon në afarizmin e operatoreve si dhe cilësisë së shërbimeve. Arkëtimi i sektorit është me një normë prej 64.9% e cila është e kënaqshme në nivele të vendit. Arkëtimi i të hyrave të operatorit "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" është 74.2% i cili është dukshëm me lartë se operatorit të dytë "Ekodrinia" me 48.7%. Plani i MM si objektiv parësor ka ngritjen e normës arkëtimimit me masat e veprimet në sektor të mundësoj një ambient të shëndetshëm financiar e ligjor për të mundësuar ngritjen e vetëdijes për plotësimin e detyrimeve për shërbimet e ofruara të MM.

Tabela 10 : Norma e arkëtimimit të hyrave për vitin 2015

Kompanitë MM	Të Hyrat	Arkëtimi	% Arkëtimi
NJP "Ambienti"	224,838	166,935	74.2%
Ekodrinia	129,648	63,128	48.7%
Sektori	354,486	230,063	64.9%

Graf 4 : Norma e arkëtimit të hyrave për vitin 2015



3.3.3.Klientët në sektorit të MM për vitin 2015

Klientët e sektorit të MM në numër janë 7.697 amvisëri të segmentuara për dy operatorët aktual në largësi të ndryshme nga qendra urbane. Operatori "Ekoregjioni" – NJP "Ambienti" është i koncentruar në zonën urbane dhe rurale me normë të mbulimit të tërësishëm ndërsa operatori "Ekodrinia" ka një shtrijë në viset rurale. Largësia e klientëve ka ndikim të drejtpërdrejt në kostot e menaxhimit të mbeturinave si rezultat ka edhe ndikimin në profitabilitetin të operatorëve.

Tabela 11: Amvisëritë e shpërndara në largësi nga qendra e bazuar në operatorët në sektorin e MM

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total
NJP "Ambienti"	3,072	631	655	1,136	248	5,742
Ekodrinia	-	161	395	734	1,111	2,401
Total	3,072	792	1,050	1,870	1,359	8,143
	37.7%	9.7%	12.9%	23.0%	16.7%	100.0%
Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total
NJP "Ambienti"	100%	80%	62%	61%	18%	71%
Ekodrinia	0%	20%	38%	39%	82%	29%

3.3.4.Trajtimi i mbeturinave për vitin 2015

Trajtimi i mbeturinave të amvisërisë nga operatorët në sektorin e MM për vitin 2015 të shprehura në ton është 8.042 ton, mesatarja mujore e mbeturinave të trajtuara (të mbledhura) është 670 tonelata.

Raporti i pjesëmarrjes së trajtimit të mbeturinave për vitin 2015 në mes të operatorëve është si në vijim "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" me 64.7% (5.200 ton mbeturina), ndërsa operatori privat "Ekodrinia" i shprehur në përqindje 34% (2.842 ton mbeturina).


Trajtimi i mbeturinave të mbledhura shprehet edhe sipas efekteve të sezonit në rritjen e mbeturinave të trajtuara. Rritja e mbeturinave të trajtuara shënjon rritje në muajt qershor-shtator të vitit si pasojë e rritjes së numrit të banorëve në këtë periudhë.

Tabela12 :Raporti i pjesëmarrjes në trajtim të mbeturinave për vitin 2015

Muaji	NJP "Ambienti"	Ekodrina	Total	NJP "Ambienti" në %	Ekodrina në %
Janar	433	228	662	65.5%	34.5%
Shkurt	433	184	618	70.2%	29.8%
Mars	433	196	630	68.8%	31.2%
Prill	433	205	638	67.9%	32.1%
Maj	433	199	632	68.6%	31.4%
Qershor	433	181	615	70.5%	29.5%
Korrik	433	260	693	62.5%	37.5%
Gusht	433	358	791	54.8%	45.2%
Shtator	433	310	744	58.3%	41.7%
Tetor	433	258	692	62.7%	37.3%
Nëntor	433	240	674	64.3%	35.7%
Dhjetor	433	223	656	66.0%	34.0%
Total	5,200	2,842	8,042	64.7%	35.3%

Burimi: Të dhënat janë siguruar nga kompanitë

Graf 7: Raporti i pjesëmarrjes së trajtimit të mbeturinave për vitin 2015



Përlllogaritja e ndikimit të sezonit në trajtimin e mbeturinave e bazuar ne devijimin e sasive mesatare mujore (670 ton) nga sasia e mujore e mbeturinave të trajtuara nga operatorët shprehet në muajt korrik –nëntor, ne veçanti ne muajt qershor-gusht ku mbeturinat shënojnë rritje më të madhe.


Tabela 13: Përlllogaritja e sezonit të trajtimit të mbeturinave për 2016

Mesatarja mujore e mbeturinave

670 ton

Muaji	Total	Dif.nga Mesat.ne Vlere	Dif.nga Mesat.ne %
Janar	662	-8	-1.3%
Shkurt	618	-53	-7.9%
Mars	630	-41	-6.1%
Prill	638	-32	-4.8%
Maj	632	-38	-5.7%
Qershor	615	-55	-8.3%
Korrik	693	23	3.4%
Gusht	791	121	18.0%
Shtator	744	74	11.0%
Tetor	692	21	3.2%
Nëntor	674	4	0.5%
Dhjetor	656	-14	-2.1%
Total	8,042		

Graf 8 : Përlllogaritja e sezonit të trajtimit të mbeturinave për 2016



Me aplikimin e modelit është vlerësuar sasia e përlogaritur e mbeturinave në vit është 10.611 ton mbeturina. Me krahasimin e mbeturinave të trajtuara me mbeturinat e përlogaritura është vlerësuar se në nivel vjetor nuk trajtohen 2.569 ton mbeturina të shprehur në përqindje 24.2% të cilat janë të deponuara në lokacione e forma të ndryshme të ndryshme.

Tabela 14: Raporti i mbeturinave të përlogaritura me mbeturinat e trajtuara për 2015

Muaji	Te Përlogaritura	Te trajtuara	Diferenca
Janar	873	662	211
Shkurt	815	618	197
Mars	831	630	201
Prill	842	638	204
Maj	834	632	202
Qershor	811	615	196
Korrik	914	693	221
Gusht	1,043	791	253
Shtator	981	744	238
Tetor	913	692	221
Nëntor	889	674	215
Dhjetor	866	656	210
Total	10,611	8,042	2,569

3.4.Zbatimi financiar i PLMM për periudhën 2016 -2021

Objektiva kryesore e planit është mbulimi i plote i zonës me shërbime të MM në periudhën e planit. Në vitin 2016 janë 10 (dhjetë) lokalitetet të cilat janë pjesërisht të mbuluara me shërbime të MM:

- Ekonomitë Familjare 533
- Numri i Lokaliteteve 10
- Numri i banorëve 2,256
- Mbeturinat e Gjeneruara (në ton) 439

Tabela 15:Lokalitetet pjesërisht të mbuluara me shërbime të MM në vitin 2016

Zona	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Ekonomi Famil.	Ekonomi Famil./Te Mbulura	Ekonomi Famil./Pa Mbulura	Gjen.Mbet.ne Vit-Ton	Mbet. Jo-te-Menaxh.	Koef.Mbul.ne %	Koef.Jo-Mbul.ne %
Nushpal	Zona 2	7	6-9	220	32	22	10	40	13	68.3%	31.7%
Senoc	Zona 2	7	6-9	687	101	69	32	125	39	68.6%	31.4%
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	808	162	60	102	147	93	37.1%	62.9%
Gexhë	Zona 2	12	9-12	660	165	68	97	120	71	41.2%	58.8%
Kaznik	Zona 2	13	12-40	164	24	8	16	24	16	33.3%	66.7%
Bratotin	Zona 2	21	12-40	396	58	24	34	58	34	41.4%	58.6%
Dabidoi	Zona 2	21	12-40	799	138	36	102	117	86	26.1%	73.9%
Sarosh	Zona 2	23	12-40	6	2	1	1	1	0	50.0%	50.0%
Petkoviq	Zona 2	28	12-40	731	183	56	127	107	74	30.6%	69.4%
Mrasor	Zona 2	32	12-40	191	28	15	13	28	13	53.6%	46.4%
Total				4,662	892	359	533		439	40.3%	59.7%

Tabela 16:Perfshirja e ekonomive familjare në sistemin e MM për periudhën 2017-2021

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomitë Familjare	-	393	140	-	-	-	533
Nr. Lokalitetet	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banorëve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara (në ton)	-	352	87	-	-	-	439

Tabela 17: Përlllogaritja e te hyrave -implementimi i MM 2016-2021

Kategoritë	2016	2017	2018
Ekonomitë Familjare	-	393	140
Te hyrat e përlllogaritura(Tarifa 4.5 EURO) ne vit	-	21,232	7,545
Te përjashtuar nga pagesa	20.0%	20.0%	20.0%
Te hyrat e projektuara	-	16,986	6,036
Te hyrat Vjetore	-	16,986	6,036
Total Te hyrat(Komul.)	-	16,986	23,021

4. Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të një politike të propozuara, iniciativave të një plani apo programi me qëllim të sigurimit se ato janë përfshirë plotësisht dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme në fazën më të hershme të përshtatshme të vendimmarrjes, në të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe sociale.³

Qëllimi kryesorë i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe që ti kontribuoj promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM-ja synon përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektivat apo strategjitë e reja, si dhe duke rishikuar strategjitë e propozuara dhe sugjeruar ato që mund të jenë më të mira në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe minimizimit dhe parandalimit të ndikimeve dhe rreziqeve në mjedis. VSM-ja si proces duhet të fillojë në fazat fillestare të procesit të përgatitjes së planit dhe duhet të zhvillohet paralel me planin dhe të integrohet plotësisht në të.

Parimet themelore mbi të cilat është e bazuar VSM-ja janë :

- **Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm**, që nënkupton shqyrtimin dhe përfshirjen e aspekteve qenësore të mjedisit në përgatitjen dhe aprovimin e planeve dhe programeve të caktuara dhe me konfirmimin e kushteve për ruajtjen e të mirave materiale, vlerave të kulturës dhe të natyrës, hapësirave, llojllojshmërisë biologjike, llojeve të egra bimë dhe shtazore dhe ekosistemeve autoktone, respektivisht të shfrytëzimit racional të resurseve natyrore, kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm.
- **Parimi i integritetit**, që kërkon zbatimin e Politikave të mbrojtjes së mjedisit të cilat realizohet përmes sjelljes së planeve dhe programeve bazohet në përfshirjen e kushteve të mbrojtjes së mjedisit, gjegjësisht ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe llojllojshmërisë biologjike në planet dhe programet ndër sektoriale.
- **Parimi i kujdesit**, që nënkupton që çdo aktivitet duhet të zbatohet në atë mënyrë, që para miratimit, të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet negative të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis të sigurojë shfrytëzim racional të resurseve natyrore dhe zvogëlojë rrezikun për shëndetin e njeriut dhe të mirave materiale.
- **Parimi i hierarkisë dhe koordinimit**, që në përcakton se vlerësimi i ndikimit të planeve dhe programeve kryhet në nivel qendror për planet ose programet që nxirren në nivelin qendror dhe lokal dhe se në procedurën e VSM-së, të planeve ose programeve, ngritja e shkallës së transparencës në vendimmarrje sigurohet në koordinim të ndërsjellë të organeve dhe organizatave kompetente në procedurën e dhënies së pëlqimit për VSM, përmes konsultimeve, respektivisht njoftimit dhe dhënies së mendimit për ato plane ose programe.
- **Parimi i informimit publik**, i cili zbatohet më qëllim të informimit të publikut për planet ose programet e caktuara dhe për ndikimin e mundshëm të tyre në mjedis dhe më qëllim të sigurimit të transparencës së plotë gjatë procedurës së përgatitjes, nxjerrjes dhe miratimit të planeve ose programeve, para marrjes së vendimit, si dhe pas miratimit të planeve ose programeve, publiku patjetër duhet që të ketë qasje në informata të cilat kanë të bëjnë me ato plane ose programe dhe modifikimin e tyre.

Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji nr. 03/230), i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për zbatimin e VSM-së. Ky ligj është në përputhje me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Strategic Environmental Assessment Directive 2001/42/EC).

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë e specifikon që procedura e VSM-së të përbëhet nga:

³Sadler and Verheem, 1996

- Përgatitja e një raporti të VSM-së në lidhje me ndikimet e konsiderueshme të draftit të planit ose programit (PP) në rast se ai plan/program pas skanimit sipas kriterëve të përcaktuara me ligj ka efekt negativ në mjedis;
- Konsultimi i organeve relevante, dhe publikut të gjerë, për draftin e Planit ose Programit dhe raportin shoqërues të VSM-së;
- Marrja në konsideratë e raportit për VSM-në dhe rezultateve të konsultimit në vendimmarrje;
- Komunikimi i rezultateve të VSM-së dhe përfshirja e rezultatit të saj në Planin ose Programin përkatës.

Sipas Ligjit Nr. 03/230 konkretisht sipas nenit 3, VSM-ja është e detyrueshme për Planet dhe Programet si në vijim:

- Planet dhe Programet që janë të përgatitura për planifikim hapësinor, planifikim të qytetit, shfrytëzim të tokës, bujqësi, pylltari, peshkatari, gjueti, energji, industri, miniera, komunikacion, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikacion, turizëm, dhe të përbejnë kornizën për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së sipas Ligjit për VNM;

Në anën tjetër duke parë objektivat që ky plan synon të arrijë, mund të vihet në përfundim që të mos përgatitet raport të VSM për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave (PLMM) në komunën e Rahovecit dhe kjo është në përputhje me nenin e lart përmendur. Pika 2 e këtij neni potencon se "... VSM është i detyrueshëm për planet nga fusha e ... menaxhimit të mbeturinave..."; Por, në pjesën e dytë të po këtij paragrafi vazhdohet "... të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis për përputhje me ligjin..."

Ndërsa neni 5 thotë:

Neni 5 Përcaktimi i nevojës për VSM,

1. Autoriteti përgjegjës duhet që të përcaktoj nga hulumtimi i secilit rast veç e veç, mbështetur në kriteret e Shtojcës 1, për planet ose programet referuar në nenin 3, paragrafi 3. dhe 4. i këtij ligji, se a kanë ndikim të theksuar në mjedis në mënyrë që ti nënshtrohen VSM.

Grupi punues për përgatitjen e PLMM, duke ju referuar provizionit të lartë përmendur, ka shqyrtuar PLMM duke krahasuar me kriteret e shtojcës 1 të ligjit për VSM, dhe nga ku gjithashtu është konstatuar se PLMM nuk pritet të ketë ndikime të mëdha në mjedis, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet procedurës së VSM.

Plani i Menaxhimit të mbeturinave përfshinë:

- Blerjen e pajisjeve për Menaxhimin e Mbeturinave
- Mjetet e Transportit /Garazhi
- Ndërgjegjësimin i Publikut
- Ndarjen e mbeturinave

Plani i Menaxhimit të mbeturinave nuk përfshinë:

- Projekte dhe intervenime të mëdha inxhinierike të cilat ndikojnë në mjedis
- Ndërtimin e deponive
- Ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse, siç janë stacione transferi të mbeturinave apo impiant për trajtim të mbeturinave
- Projekte të tjera, për të cilat sipas ligjit do të kërkohej vlerësimi i ndikimit në Mjedis;

1. ANALIZA KRAHASUESE SIPAS KRITEREVE TË SHTOJCËS 1 TË LIGJIT PER VSM Nr. 03/L-230, SI DHE AKTIVITETEVE TË PM TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Kriteret e vlerësimit sipas shtojcës 1 të ligjit të VSM	Efektet e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave (PLMM) të komunës së Rahovecit
1. Karakteristikat e planeve dhe të programeve, duke pasur parasysh në veçanti	
1.1. shkallën në të cilën një plan ose program përcakton kuadrin e projekteve dhe të aktiviteteve të tjera, ose lidhja e tyre me vendndodhjen, natyrën, madhësinë dhe kushtet operuese ose me burimet e përcaktuara,	PLMM nuk parasheh zhvillimin e projekteve (infrastruktura, objekte përcjellëse në trajtim të mbeturinave) të cilat do t'i nënshtroheshin procedurës sipas ligjit për VNM. Objektivat kryesor do të jenë mbulimi sa më i madh i territorit komunal me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave.
1.2. shkallën në të cilën plani ose programi influencon plane dhe programe të përfshira dhe ato në hierarki,	Ky plan është në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Komunal të cilit po ashtu i është bërë VSM, dhe nuk influencon, planet tjera ekzistuese qoftë ato komunale apo kombëtare
1.3. lidhjen e planit ose programit për integrimin e konsideratave mjedisore në veçanti në lidhje me promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm,	Në përgjithësi, plani është në harmoni me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke propozuar masa për mbulim sa më të gjërë të konsumatorëve, duke rritur kualitetin e shërbimit por edhe duke promovuar ndarjen e mbeturinave në burim.
1.4. probleme mjedisore që lidhen me planin ose programin,	Në objektivat e parapara në kuadër të Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për komunën e Rahovecit, nuk është hasur në probleme të mundshme mjedisore që mund të paraqiteshin si pasojë e realizimit të objektivave të cekura më lartë.
1.5. përputhshmërinë e një plani ose programi për zbatimin e legjislacionit të Komunitetit mbi mjedisin (p.sh planet dhe programet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e ujit).	Duhet thënë se plani si plan kërkohet sipas legjislacioneve qoftë mjedisore apo ato të vetëqeverisjes lokale, dhe që si synim ka promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimin e kualitetit të jetës dhe mjedisit etj. Ndër të tjera vlenë të ceket se ky plan dhe të gjitha objektivat e përfshira në këtë plan janë në harmoni të plotë me Planin e Zhvillimor Komunal i cili ka kaluar nëpër procesin e VSM.
2. Karakteristika të efekteve dhe të zonave që ka të ngjarë të ndikohen, duke pasur parasysh, në veçanti;	
2.1. probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe natyrën e efekteve,	PLMM përfshinë periudhë 5 vjeçare (2016-2021). Gjatë këtyre viteve pritet të ketë rritje të efekteve të cilat do të jenë pozitive. (shih pikën 1.3)
2.2. natyrën kumulative të efekteve,	Plani nuk parasheh efektet cilat në kontekstin kumulativ do të rezultojnë me pasojë mjedisore. Përkundrazi me rritjen e mbulueshmërisë të mbledhjes së mbeturinave, do të ketë reduktim të hujdheve të pa-kontrolluara

	(ilegale) të mbeturinave, gjë që kontribon direkt në ngritjen e kualitetit mjedisor në komunë.
2.3. natyrën ndërkufitare të efekteve, 2.4. rrezikun e shëndetit të njeriut mbi mjedis (psh si shkak i aksidenteve),	Nuk do të ketë efekte negative ndërkufitare. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave është i karakterit lokal. Priten efekte pozitive, që do të jenë direkte.
2.5. shkallën dhe shtrirjen hapësinore të efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë që mund të preken),	Efektet pozitive mjedisore të këtij plani , deri në fund të vitit 2021 do të prekin 100 % të territorit, dhe 62300 banorë të komunës së Rahovecit.
2.6. vlerën dhe cënueshmërinë e zonës që ka të ngjarë të ndikohet si rezultat i:	
2.6.1. karakteristikave të veçanta natyrore ose trashëgimisë kulturore,	Duke qenë se PLMM nuk parasheh ndërhyrje fizike, ndërtim të objekteve, infrastrukturës, prerje të pyjeve, zënie tokash, gërmime etj, nuk do të ketë dëmtim/degradim të zonave natyrore apo trashëgimisë kulturore.
2.6.2. standardeve mjedisore të tepërta dhe vlerave limit,	PLMM nuk parasheh projekte të cilat do të rezultojnë me emisione qoftë në ajër qoftë në ujë, e të cilat do të ishin subjekt i shqyrtimit në kontekstin e tejkalimit të standardeve apo vlerave kufitare.
2.6.3. përdorimit intensiv të tokës.	PLMM nuk parasheh zënie apo përdorim të tokave, të gjitha veprimet sipas objektivave do të bëhen në gjendjen ekzistuese.
2.7. efektet mbi zonat ose sipërfaqet që kanë një status të njohur kombëtar, Komunitar ose ndërkombëtar mbrojtës.	Komuna e Rahovecit shtrihet në jug-perendim të Kosovës. Kufizohet në veri me komunën e Klinës, në lindje me komunën e Suharekës në perendim me Gjakovën ndërsa në jug me Prizrenin. Territori i komunës së Rahovecit është kryesisht territor rural, pyjor edhe në afërsi të saj gjendet Manastiri i Zoqishtës dhe Fshati Hoqë e Madhe e cila ka status mbrojtës të njohur kombëtar dhe komunitar por që PLMM pritet të ketë vetëm efekt pozitiv.

5. Ndërgjegjësimi i publikut

Të gjithë palët e interesit duhen të kenë të qartë objektivat e PLMM. Ndërgjegjësimi krijohet duke krijuar një identitet të fortë të planit dhe duke e komunikuar këtë me konsistencë dhe njëtrajtësisht. Përkrahja nga sektori publik është esenciale për komunitetin në mënyrë që të identifikojë se pse është i rëndësishme ndryshimi i sjelljes ndaj menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë mënyrë të pranojë nevojën për deponim të mbeturinave ashtu siç duhet të jetë, pra ta pranojë se edhe vetë komuniteti është pjesë e zinxhirit në menaxhimin e mbeturinave komunale.

Pjesa e mëposhtme shpjegon ndërgjegjësimin publik për implementimin e PLMM për komunën e Rahovecit.

5.1. Ndërgjegjësimi publik dhe strategjia për informim

Strategjia për ndërgjegjësim do të jetë një strategji në vete, ku do të mundësojë implementimin e PLMM me kyçjen e sa më shumë akterëve, kjo strategji është me rëndësi që të jetë në harmoni edhe me politikat vendore si e tillë do të kishte 4 pika:

- Caqet – objektivat kryesore/caqet sipas legjislacionit në fuqi
 - Çështjet kryesore – fokusimi në çështjet lokale kryesore
 - strategjia dhe implementimi – mesazhe të orientuara për publikun e gjerë, mënyrat e komunikimit dhe teknikat për ti arritur këto objektiva
 - përqimi i mesazheve – kjo do të përfshinte zhvillimin e mesazheve kyçe, ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e palëve të involvuara.
- Kampanja e vetëdijësimit publik do ta krijojë bazament duke pasur parasysh objektivat e planit që do të duhet të arrihen, po që si shembull mund të përfshinte:
- a) shpjegimin e vijave të reja dhe esencës së mbulueshmërisë së territorit me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave
 - b) rritja e pjesëmarrjes së publikut në aktivitetet e reciklimit, por edhe siç është cekur në dokument të fillohet iniciativa për ndarjen e mbeturinave në burim.
 - c) përmirësimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave.

5.1.1 Caqet

Kontekstit për këtë strategji komunikimi do të vendoset në një numër të niveleve të ndërlidhura të cilat janë:

- Politikat e BE-së

Siç dihet politikat e BE-së për menaxhimin e mbeturinave japin caqe të caktuara se ku duhet të arrijë cdo shtet që synon antarsimin dhe që duhen përmbushur.

Ndër tjera këto përfshijnë direktivat e deponive, direktivat e menaxhimit të mbeturinave, masat të cilat duhen të ndërmerren nga niveli lokal në menaxhimin e mbeturinave etj. Këto caqe të listuara në direktiva janë shpeshherë sfiduese dhe kërkojnë ndryshim të çasjes së deri-tanishme, kërkojnë participim më i shpeshtë dhe më interaktiv i publikut.

- Politikat Nacionale të menaxhimit të mbetjeve

Në Kosovë ekziston ligji për menaxhimin e mbetjeve, Strategjia dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave të cilat si dokumente mund të shërbejnë si udhëzues të mirë dhe të ndihmojnë edhe më tutje komunat në implementimin e PLMM. Së shpejti do të përgatitet edhe një studim tjetër mbi mbeturinat i cili mbështetet nga GIZ dhe implementohet edhe me ndihmën e MMPH-së.

Për arritjen e këtyre caqeve kërkojnë një bashkëpunim sa më aktiv i palëve të interesit nga i gjithë regjioni. Të gjithë akterët duhet që të mund të identifikojnë se pse duhet që ky ndryshim i çasjes së deri tanishme në aspektin e menaxhimit të mbeturinave të ndodh.

Disa nga propozimet për çasje sa më direkte në publik dhe për përçimin e mesazhit mund të jenë këto:

- Edukimi mjedisor në shkollat e komunës përmes krijimit të klubeve mjedisore në shkolla
- Organizimi i vizitave studimore në deponi të mbeturinave për të parë nga afër menaxhimin e tyre dhe rëndësinë e reduktimit të mbeturinave karshi nxënjes së hapësirave të gjelbërta
- Gara mes shkollave në pikturë me tematikë mbeturinat
- Gara mes shkollave për të ndërtuar/dizjenuar prej mbeturinave të recikluara
- Mirënjohje për kompanitë private për arritjet dhe kontributet e tyre në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në komunë
- Kompostimi në shtëpi (mundësia e përfitimit të komposterëve përmes granteve)
- Promovimi i reciklimit në shkolla
- Organizim vjetor i ndonjë ngjarjeje, koncert/gjysmë-maratonë kundër mbeturinave.

Të gjitha këto propozime në rast se implementohen do të kontribuonin në ngritjen e vetëdijes qytetare duke filluar nga nxënësit e shkollave fillore dhe duke u transmetuar në shtëpitë e tyre dhe kjo strategji e vetëdijësimit publik normalisht që është në harmoni me PLMM-në e përgatitur dhe do po ashtu do të ndihmojë në:

- zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që prodhohen
- ngritjen e vetëdijes për ndarjen e mbeturinave në burim

5.1.2. Çështjet kryesore

Do të ketë katër fusha kryesore qendrore në strategjinë fillestare të informimit publik dhe të vetëdijes për komunën e Rahovecit dhe ato janë:

Detyra është urgjente - Fushata do të përcaktoj sasinë shkallën e detyrës në nivel lokal dhe të bëjnë lidhjen mes saj dhe nevojës për të gjithë për të marrë pjesë në iniciativat lokale të organizuara në komunën e Rahovecit.

Komuna është e gatshme - Fushata do të ilustrojë në mënyrë të qartë se autoritetet në komunë janë të gatshëm për të përmbushur këtë sfidë.

Me terme si p.sh. "Kjo është ajo që ju duhet të / mund të bëjë" - mesazhe të qarta dhe të thjeshta do të transmetohen palëve të interesuara (ekonomive familjare, shkollave, biznesit dhe bujqësisë, udhëheqësve të komunitetit, etj) në lidhje me detyra të thjeshta ditore që ata mund të kryejnë për të ndihmuar në arritjen e objektivave. Kjo do të përfshinte mesazhe të qarta për parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve të cilat do të lidheshin me eventin "Gara në vrap/koncerti kundër mbeturinave"

5.1.3. Strategjia dhe Implementimi

Strategjia do të përfshijë një numër të elementeve të ndërlidhura, disa të përkohshme dhe disa të përhershme. Aspektet e përkohshme do të jetë e lidhur kryesisht për rritjen e ndërgjegjësimit kurse ato të përhershme me aspektet e arsimit.

5.1.4. Përçimi i mesazheve

Fushata kryesore do të përfshijë katër faza të gjëra:

- Zhvillimi - Identifikimi i mesazheve dhe imazheve kryesore dhe zhvillimin e komunikimit (mjetet dhe materialet). Një qasje fleksibile është thelbësore gjatë zbatimit të fushatës së komunikimit dhe arsimit pasi që situata në terren mund të ndryshojë sipas çështjeve që lindin.
- Ndërgjegjësimi: duhet të jetë i profilit të lartë me impakt të gjërë në mënyrë që ti involvojë dhe ti entuziazomj për të vepruar edhe akterët më të lartë e palët e interesit
- Arsimi - një program i lartëpërmendur që përsëritet vazhdimisht për ti mbajtur çështjen e mbeturinave në mendjet e njerëzve dhe në të njejtën kohë të ofrojë këshilla dhe informacion se çka apo si duhet bërë për të marrë pjesë; një informim i vazhdueshëm do të ndihmoj në ruajtjen e niveleve të ndërgjegjësimit
- vlerësimi – duke u zbatuar plani duhet që njëkohësisht edhe të matet në mënyrë që të identifikohet se ku mund të ri-shfaqen masazhet e nevojshme dhe gjithashtu ku sukcesi mund të jetë vërejtur, të regjistrohet për të ndihmuar në ruajtjen e motivimit.

6. Plani i Veprimit

6.1. Qartësimi i përgjegjësive të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes lokale

Komuna e Rahovecit në radhë të parë si përgjegjëse kryesore për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të mbeturinave në kufijtë e saj administartiv, në anën tjetër banorët dhe bizneset afariste po ashtu duke marrë rol aktiv, ashtu sic u cek më sipër në kapitullin e “Vetëdijësimit” duhet që së bashku të ndërtojnë një sistem të duhur të MM, duke marrë përgjegjësitë secili veç e veç dhe së bashku:

Banorët

Banorët janë të obliguar ta paguajnë taksën brenda afateve të caktuara nga Komuna e Rahovecit.

Respektimi i rregullave të shkarkimit

Një nga hallkat krejsore të funksionimit të mirëfilltë të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave është që edhe banori para së gjithash të respektoj dhe përfillë mënyrat e shkarkimit të caktuara nga Komuna. Banorët të cilët jetojnë në ato pjesë të qytetit ku bëhet grumbullimi i veçantë i kartonëve dhe metaleve, i ndajnë gjërat e riciklueshme ashtu si duhet dhe konform udhëzimeve të dhëna nga Komuna.

Bashkëpunimi aktiv në Plan

Banorët aktivisht bashkëpunojnë me masat e ndërmarra nga qeveria për implementimin e planit të menaxhimit të mbeturinave. Komuna në të shumtën e rasteve e bënë maksimumin për ta mbajtur nën kontroll ndotjen nga mbeturinat, por është e pamundur që të arrihet kjo në të shumtën e rasteve, andaj nga qytetarët kërkohet që të sigurohen që vendet që i rrethojnë janë të pastra, pra të vet-involvohen në pastrimin e hapësirave që i rrethojnë.

Bizneset

Parimi ndotësi paguan

Bizneset paguajnë brenda afateve të caktuara nga Komuna.

Bizneset të shkallës së lartë, individualisht duhet të bëjnë kontraktimin për shërbimin e grumbullimit dhe transportimit me ofruesin e Shërbimeve të licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Prandaj, bizneset të shkallës së lartë duke kontraktuar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, në baza vjetore duhet të raportojnë në Komunë për sasinë e shkarkuar të mbeturinave, kjo do ti mundësojë komunës që të mbajë evidencën e llojit dhe sasisë së mbeturinave të krijuara nga bizneset e mëdhaja në komunë dhe të evidentoj dhe identifikoj nëse për çfarëdo arsye mbeturinat e tyre janë hedhur diku tjetër p.sh. ne deponi ilegale.

Duke u thirrur në principin “Ndotësi paguan” pastaj komuna me këto fakte të evidentuara do të ketë më të lehtë ta gjobisë ndotësin.

Në anën tjetër komuna nuk duhet ta ketë rolin e “kujdestarit” por me anë të iniciativave të ndryshme duhet që edhe bizneset ti involvojë në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave e po ashtu edhe bizneset do të duhen të marrin aktivisht pjesë në aktivitetet për redukim, riciklim dhe riperdorim duke qenë bartës apo mbështetës të aktiviteteve specifike.

Qeverisja Lokale

Shkarkimi i duhur i mbeturinave

Komuna bënë përpjekje për të krijuar një shërbim grumbullimi dhe transportimi të shëndoshë duke marrë parasysh efikasitetin, mjedisin dhe higjienën. Komuna përpiqet të minimizojë mbeturinat përmes aktiviteteve të 3R bashkë me banorët dhe bizneset sipas aktiviteteve të paraqitura edhe në kapitullin “Vetëdijesimi”.

DRAFT

6.2. Përmbledhje e Planit të Zbatimit 2016-2021

Nr	Masat	Qëllimi i investimit	Veprimet Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore (kuartal-Q)	2016	2017	2018	2019	2020	2021
1	O1 M1	Përfundimi i PLMM	Grupi Punues/DEMOS	Q3 2016						
2	O1 M2	Diskutimi publik	Grupi punues/DEMOS	Q4 2016						
3	O1 M3	Aprovimi në Asamblenë Komunale	Grupi punues	Q4 2016						
4	O1 M4	Rishiqimi i PLMM	Grupi punues	Q2 2018						
5	O2 M1	Komuna te përgatisë rregulloren e brendshme te funksionimit për ndërmarrjen e cila merret me pastrim/gjellbërimit sipas Zonave , ne mënyre te veçantë për shërbimin e pastrimit ku te përcaktohen detyrat dhe te drejtat e personelit	Komuna	Q1 2017						
6	O2 M2	Formimi dhe fuqizimi i sektorit për me menaxhimin e mbeturinave	Komuna	Q2 2017						
7	O2 M3	Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit nga kompanitë ekzistuese në periudhën transitore. Ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët privat ose themelimit të ndërmarrjes publike	Komuna /Operatorët MM/sektori privat/OJQ- të/Banorët	2017-2021						
8	O3 M1	Reduktimi i deponive ilegale dhe shndërrimi i një pjese të tyre në hapësira të përshtatshme për banorë,	Komuna /Operatorët MM/sektori privat/OJQ- të/Banorët	2017-2021						
9	O3 M2	Rritja graduale të përfshirjes së popullatës në sistemin e trajtimit të mbeturinave,	Komuna/MMPH/ Operatorët MM/sektori privat/OJQ- të/Banorët/Sistemi arsimor komunal	2017-2021						
10	O3 M3	Përcaktimi i tarifës	Komuna	2017						
11	O3 M4	Rritja e inkasimit për grumbullimin e mbeturinave	Komuna	2017-2021						
12	O3 M5	Krijimin e bazës së të dhënave qendrore dhe informacionit mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave	Komuna	2016-2017						

13	O4 M1	Te siguroj blerjen e makinerisë se nevojshme për mbledhjen e mbeturinave	Komuna /Kompania MM	2017-2018						
14	O4 M2	Mjetet e Transportit/Garazhi	Kompania MM	2017						
15	O4 M3	Ndërgjegjësimi i Publikut	Komuna/ Operatorët MM/sektori privat/OJQ-të/Banorët/Sistemi arsimor komunal	2016-2021						
16	O4 M4	Fillimi i ndarjes së mbeturinave dhe riciklimi-pilot projektet	Komuna /Kompania MM	2018-2021						
17	O4 M5	Përcaktimi i lokacionit dhe marrja e aprovimeve për Deponinë e Mbetjeve Ndërtimore	Komuna	Q1 2017						
18	O4 M6	Aktivizimi i deponisë për Mbetje Ndërtimore	Komuna	Q2,3 2017						

7. Monitorimi dhe rishikimi

Në kuadër të funksionit si 'klient', Komuna e Rahovecit duhet të sigurohet që shërbimet ofrohen sipas standardeve të kërkuara, që ato përmbushin pritshmëritë e banorëve dhe se janë në përputhje me parimet mjedisore. Zbatimi i funksionit të kontrollit do të kërkojë monitorim dhe kontroll të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve, kontratave apo marrëveshjeve të tjera si dhe do të garantojë përmbushjen e standardeve dhe kushteve nga ana e operatorit të shërbimeve si dhe masave që janë paraparë në këtë plan. Nga ana tjetër, monitorimi i shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera të mbeturinave do t'i mundësojë komunës së Rahovecit ti njohë shpenzimet, burimet njerëzore dhe përdorshmërinë e pajisjeve, të përshtasë dhe përmirësojnë sistemin sipas nevojave të vërteta dhe të arrijnë një përparim të vazhdueshëm (për sa i përket cilësisë dhe efikasitetit), si dhe të planifikojë pajisjet e nevojshme për organizmin e shërbimeve dhe aktiviteteve të mbeturinave në të ardhmen.

Është e rëndësishme të monitorohet progresi dhe efektiviteti i masave që janë marrë.

Monitorimi i zbatimit mund të konsiderohet si përfshirje e katër elementëve:

- Efikasiteti i zbatimit – monitorimi i performancës
- Efektiviteti i këtyre veprimeve – monitorimi i përpuethshmërisë
- Identifikimi i nevojave të reja – reagimi ndaj ndryshimit
- Rishikimi i planit të veprimit

Vetëm duke i analizuar elementet e mësipërme do të jetë e mundur të gjendet rruga e duhur.

Qeveritë lokale për zbatimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave duhet të mbështeten si nga Autoritetet Rajonale, ashtu edhe nga Institucionet Qëndrore, duke përfshirë këtu Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Agjensionin e Mbrojtjes së Mjedisit, Agjensionin Pyjor si dhe nga organizatat e ndryshme joqeveritare.

Koordinatori i përgjithshëm për zbatimin e PLMM do të jetë DSHP - Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) e cila aktualisht nuk ekziston, por rekomandohet fuqishëm që të krijohet sa më parë që të jetë e mundur. Në të njëjtën kohë, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave do të jetë autoriteti kryesor që do të monitorojë rezultatet e zbatimit të këtij PLMM që lidhet vetëm me menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit.

Një ekip (Grupi Punues për Mjedis-GPM⁴), si pjesë e stafit të Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, do të ketë në ngarkim monitorimin e procesit. GPM e cila funksionon në kuadër të drejtorisë së Inspeksionit do të fillojë të punojë menjëherë edhe tek Drejtoria e Shërbimeve Publike sapo të fillojë zbatimin e këtij PLMM. Njerëzit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të kenë autoritet zyrtar dhe njohuri për fushën për të realizuar funksionet e monitorimit. Gjithashtu duhet të ketë një numër të mjaftueshëm njerëzish për të siguruar që janë matur të gjithë treguesit e monitorimit, që janë përpunuar të dhënat dhe që në fund janë arritur konkluzionet.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave do të jetë hartimi i planit të monitorimit, i cili duhet të jetë në përputhje me treguesit që vijnë:

- 1) Cilët tregues do të monitorohen?
- 2) Si do të monitorohen këta tregues?
- 3) Kur dhe sa shpesh do të monitorohen këta tregues?
- 4) Kush është personi përgjegjës për monitorimin e treguesve specifikë?
- 5) Kush personi përgjegjës për analizimin e të dhënave?

⁴ Grupi Punues për Mjedis do të themelohet nga Kryetari i Komunës ku përfshihen drejtoritë relevante

- 6) Kur do të fillojë monitorimi i këtyre treguesve specifikë?
 7) Cilat janë të dhënat bazë (fillestare) për secilin nga treguesit që do monitorohen?
 8) Sa do të jetë kostoja e monitorimit?

Monitorimi do të ndërmerret duke përdorur një gamë treguesish. Një grup kryesor që përmban llojet e treguesve që vijnë do të raportohet vazhdimisht:

- Treguesit e Performancës së Infrastrukturës Mjedisore
- Treguesit financiarë
- Treguesit administrativë (Nr. i rregulloreve, gjobave, raportet etj.)

Me qëllim lehtësimin e procesit të monitorimit që lidhet me këtë PLMM, janë dhënë në tabelen e mëposhtme treguesve të qartë që duhen marrë në konsideratë për matjet sic janë: treguesve të suksesit, rezultate që synohen të arrihen, autoriteti përgjegjës dhe impakti i parashikuar.

7.1. Përcaktimi i treguesve të performancës dhe burimet e verifikimeve

Objektivat	Aktivitetet	Autoritetet Përgjegjëse	Treguesit e Suksesit	Ndikimi/Efektet
1. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave	Dërgimi i PLMM në Asambleen Komonale për miratim Rishikimi dhe përditësimi i PLMM në përputhje me Planin operativ të përditësuar përfshirë edhe planin e monitorimit	Komuna e Rahovecit Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i menaxhimit të mbeturinave	Aprovimi i PLMM nga Kuvendi	Hyrja në fuqi dhe zbatimi i PLMM Përmirësim i shërbimeve të MM dhe mjedis më i pastër
2. Rritja e përqindjes së inkasmit nga grumbullimi i mbeturinave	Identifikimi i amvisërve që nuk e paguajnë tarifën e mbeturinave fare dhe i amvisërve që nuk e paguajnë këtë tarifë rregullisht dhe bërja e tyre publike Vendosja e gjobave dhe masave detyruese amvisërve që nuk e paguajnë tarifën e mbeturinave dhe ngritja e ndërgjegjësimit të amvisërve që nuk i paguajnë mbeturinat	Sektori i menaxhimit të mbeturinave Banorët OJQ-të Drejtoria e Inspektoriatit dhe Grupi punues për Mjedis	Numri i lajmërimeve publike Numri i gjobave të vëna për amvisërit që nuk paguajnë tarifën.	Transparencë e rritur Rritje e të ardhurave nga tarifa e MM dhe rritje e ndërgjegjësimit të qytetarëve
3. Krijimi i një Sektorit të veçantë për Menaxhim të Mbeturinave në Komunën e Rahovecit	Krijimi i Sektorit të MM në strukturën organizative të Komunës së Rahovecit dhe paisja e zyrave të drejtorisë me stafin përkatës (të paktën 3 punonjës duhet të punësohen)	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Sektorit i Menaxhimit të Mbeturinave, prezent në organogramën e Komunës së Rahovecit dhe plotësisht funksionale dhe numri i stafit	Përditësim i të dhënave të besueshme. Shërbime më të mira të MM. Më shumë shance për të tërhequr investime përkatëse.
4. Përfshirja e Bizneseve të Riciklimit	Bizneset e riciklimit bëjnë reklamë në mediane dhe shkruar ose elektronike. (Reklamat duhet të përqëndrohen tek përfitimet që sjell riciklimi në mjedis dhe shoqëri)	Bizneset e Riciklimit	Numri i reklamave të bëra. Numri i publikimeve në media.	Rritje e ndërgjegjësimit të publikut për riciklim. Rritje e sasisë së materialeve të ricikluar

	Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Bizneseve të Riciklimit dhe Komunës / Institucioneve Qëndrore për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha zyrat e administratës publike.	Bizneset e Riciklimit Komuna e Rahovecit Institucionet Qëndrore	Numri i Memorandumeve të Mirëkuptimit të firmosura.	Ulje e sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi. Rritje e punësimit në industrinë e riciklimit.
5.Vetëdijësimi publik	Mbajtja e aktiviteteve sipas listës në kapitullin e Vetëdijësimi publik	Komuna e Rahovecit, klubet mjedisore në shkolla, bizneset dhe banorët	Numri i aktiviteteve të organizuara	Ndërgjegjësim publik, krijim i shprehisë për menaxhim sa më të mirë të mbeturinave. Ndihmesë në implementimin e PLMM Qytet më i pastër.

Aneks I: Zonimi i territorit

1.1.Tabela përmbledhëse e veçorive të zonës –KK Rahovec

Kategoria		Numri
Numri I banoreve		56,208
Numri I ekonomive familare		8,676
Siperfaqja -ne Km ²		276
Gjenerimi I mbeturinave (E perlogaritur)		10,611

Mbulimi me sherbime të MM		Numri	Ne %
Mbulimi me sherbime të MM(ekonomi familare)		8,143	93.9%
Mos-Mbulimi me sherbime të MM(ekonomi familare)		533	6.1%

Kategoria-Zoonimi	Zona 1	Zona 2	Total
Nr.Lokalitetet	14	22	36
Mesatarja ne Km	7.90	15.64	24
Sip.Km ²	144	132	276
Nr.ekonom.famijare	6,282	2,394	8,676
Nr.ekon.fam./ofrohen sher.MM	6,282	1,861	8,143
Shkalla e mbulimit me Sher.MM	100.0%	77.7%	93.9%
Nr.Popullates	34,658	21,550	56,208
Nr.Popullates ne %	61.7%	38.3%	100.0%
Gjen.Mbet.ne Vit	7,099	3,512	10,611
Gjen.Mbet.ne Vit ne %	66.9%	33.1%	100.0%

Kategoria	Popullata	%	Sip.Km ²	%	Mbeturinat	%
Urbane	15,892	28.3%	49	17.8%	3,596	33.9%
Para Urbane	4,205	7.5%	39	14.0%	952	9.0%
Rurale	21,670	38.6%	102	37.0%	3,955	37.3%
Rurale e Thell	14,441	25.7%	86	31.2%	2,108	19.9%
Total	56,208	100.0%	276	100.0%	10,611	100.0%

Zona	Nr.Lokalitete t	Mesatarja ne Km	Sip.Km ²	Nr.ekono m.famijare	Nr.Popullates	Gjen.Mbet. ne Vit
Zona 1	14	7.90	144	6,282	34,658	7,099
Zona 2	22	15.64	132	2,394	21,550	3,512
Total	36		276	8,676	56,208	10,611

1.2.Zonimi i KK Rahovec i bazuar ne kriteret për vlerësimin e zonës ne sektorin e menaxhimit te mbetjeve

Zonat e përcaktuara për Menaxhimin e Mbeturinave –KK Rahovec		
Zona 1	Zona 2	Total
Nr.Lokalitetet 14 38.9%	Nr.Lokalitetet 22 61.1%	Nr.Lokalitetet 36 100.0%
Popullata 34,658 61.7%	Popullata 21,550 38.3%	Popullata 56,208 100.0%
Sipërfaqja km ² 144 52.2%	Sipërfaqja km ² 132 47.8%	Sipërfaqja km ² 276 100.0%
Ekon.Familjare 6,282 72.4%	Ekon.Familjare 2,394 27.6%	Ekon.Familjare 8,676 100.0%
Ofrohen sher.MM- Ekon.Familiare 6,282 77.1%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familiare 1,861 22.9%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familiare 8,143 100.0%
Mbulimit me Sher.MM 100.0%	Mbulimit me Sher.MM 77.7%	Mbulimit me Sher.MM 93.9%

1.3. Zonat përcaktuar e MM e bazuar ne Km²

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	49	-	49	17.8%
Para Urbane	31	8	39	14.0%
Rurale	55	47	102	37.0%
Rurale e Thell	10	76	86	31.2%
Total	144	132	276	100.0%
Ne %	52.2%	47.8%	100.0%	

1.3. Zonat përcaktuar e MM e bazuar gjenerimin e përlogaritur te mbeturinave

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	3,596	-	3,596	33.9%
Para Urbane	592	359	952	9.0%
Rurale	2,764	1,191	3,955	37.3%
Rurale e Thell	147	1,962	2,108	19.9%
Total	7,099	3,512	10,611	100.0%
Ne %	66.9%	33.1%	100.0%	

1.4. Shpërndarja e ekonomive familjare e bazuar ne zonat e përcaktuara dhe kompanitë ofruese te shërbimeve te MM

Opertori	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Ekodrinia	540	1,861	2,401	29.5%
NJP "Ambienti	5,742	-	5,742	70.5%
Total	6,282	1,861	8,143	100.0%

1.5. Zona 1- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr.	Zonë	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
1	Rahovec	Urbane	Zona 1	1.0	0-3	15,892	3,072	3,596
2	Krushë e Madhe	Rurale	Zona 1	10.0	9-12	4,473	779	816
3	Xërxë	Rurale	Zona 1	9.3	9-12	3,184	288	581
4	Bellacrkë	Rurale	Zona 1	7.0	6-9	2,270	252	414
5	Opterushë	Rurale	Zona 1	8.1	6-9	1,911	332	349
6	Celinë	Rurale	Zona 1	11.8	9-12	1,903	357	347
7	Brestovc	Para Urbane	Zona 1	4.3	3-6	1,288	265	291
8	Hoçë e Vogël	Para Urbane	Zona 1	5.5	3-6	1,166	224	264
9	Retijë	Rurale e Thell	Zona 1	12.9	12-40	771	124	113
10	Nagavc	Rurale	Zona 1	7.5	6-9	743	158	136
11	Zoçishtë	Rurale	Zona 1	7.1	6-9	659	165	120
12	Reti e Ulët	Rurale e Thell	Zona 1	16.4	12-40	234	124	34
13	Hoçë e Madhe	Para Urbane	Zona 1	4.8	3-6	124	142	28
14	Bërnjak	Para Urbane	Zona 1	4.9	3-6	40	-	9
Total						34,658	6,282	7,099

1.6. Zona 2- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr.	Zona	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
1	Drenoc	Para Urbane	Zona 2	5.7	3-6	1,587	161	359
2	Pataçan i Ulët	Rurale	Zona 2	11.0	9-12	1,077	103	197
3	Pastasellë	Rurale	Zona 2	9.2	9-12	1,011	83	185
4	Sapniq	Rurale	Zona 2	9.7	9-12	996	90	182
5	Polluzhë	Rurale	Zona 2	11.2	9-12	808	162	147
6	Senoc	Rurale	Zona 2	7.2	6-9	687	101	125
7	Gexhë	Rurale	Zona 2	11.6	9-12	660	165	120
8	Zatriq	Rurale	Zona 2	10.3	9-12	535	42	98
9	Pataçan i Epërm	Rurale	Zona 2	6.2	6-9	533	52	97
10	Nushpal	Rurale	Zona 2	7.0	6-9	220	32	40
11	Ratkoc	Rurale e Thell	Zona 2	17.0	12-40	3,791	380	553
12	Radostë	Rurale e Thell	Zona 2	12.3	12-40	2,346	206	343
13	Dejnë	Rurale e Thell	Zona 2	19.0	12-40	1,757	116	257
14	Çifllak	Rurale e Thell	Zona 2	23.0	12-40	1,292	104	189
15	Kramovik	Rurale e Thell	Zona 2	25.5	12-40	1,125	93	164
16	Vrajakë	Rurale e Thell	Zona 2	20.0	12-40	838	72	122
17	Dabidol	Rurale e Thell	Zona 2	20.9	12-40	799	138	117
18	Petkoviq	Rurale e Thell	Zona 2	28.3	12-40	731	183	107
19	Bratotin	Rurale e Thell	Zona 2	20.7	12-40	396	58	58
20	Mrasor	Rurale e Thell	Zona 2	32.0	12-40	191	28	28
21	Kaznik	Rurale e Thell	Zona 2	13.0	12-40	164	24	24
22	Sarosh	Rurale e Thell	Zona 2	23.3	12-40	6	2	1
Total				15.6		21,550	2,394	3,512

1.7. Zonat te bazuara ne kriteret e përcaktuara te zonimit

Zona	Nr. Banoreve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
Zona 1	34,658	6,282	7,099
Zona2	21,550	2,394	3,512
Total	56,208	8,676	10,611

Aneks II: Njohja e zonës

2.1. Numri I banoreve e ekonomive familjare

Kategoria	Popullata	Ne %	Nr.Ekonomit Familjare	Ne %
Urbane	15,892	28%	3,072	35.4%
Para Urbane	4,205	7%	792	9.1%
Rurale	21,670	39%	3,160	36.4%
Rurale e Thell	14,441	26%	1,652	19.0%
Total	56,208	100%	8,676	100.0%

2.2. Numri I banoreve ne baze te zonës ne baze te largësive

Distancat	0-3 km	3-6 km	6-9 km	9-12 km	12-40 km	Total	Ne %
Urbane	15,892	-	-	-	-	15,892	28.3%
Para Urbane	-	4,205	-	-	-	4,205	7.5%
Rurale	-	-	7,023	14,647	-	21,670	38.6%
Rurale e Thell	-	-	-	-	14,441	14,441	25.7%
Total	15,892	4,205	7,023	14,647	14,441	56,208	100.0%
Ne %	28.3%	7.5%	12.5%	26.1%	25.7%	100.0%	

2.3. Raporti I shpërndarjes se ekonomive familjare ne baze largësive ne kilometra

Per Banim	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total
Urbane	3,072	-	-	-	-	3,072
Para Urbane	-	792	-	-	-	792
Rurale	-	-	1,092	2,069	-	3,160
Rurale e Thell	-	-	-	-	1,652	1,652
	3,072	792	1,092	2,069	1,652	8,676
Ne %	35.4%	9.1%	12.6%	23.8%	19.0%	100.0%

3. Zonat kadastrave

2.4.. Sipërfaqet ne kilometra katror e bazuar ne kategori

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total
Urbane	49	-	-	-	-	49
Para Urbane	-	39	-	-	-	39
Rurale	-	-	36	66	-	102
Rurale e Thell	-	-	-	-	86	86
Total	49	39	36	66	86	276
Ne %	17.8%	14.0%	13.0%	24.0%	31.2%	100.0%

2.5. Shpërndarja se mbeturinave ne baze te largësive ne kilometra(dy kategori)

Kategoria	0-9 Km	12-40 Km	Total
Urbane	3,596	-	3,596
Para Urbane	952	-	952
Rurale	1,282	2,673	3,955
Rurale e Thell	-	2,108	2,108
Total	5,830	4,781	10,611
Ne %	54.9%	45.1%	100.0%

2.6. Shpërndarjes se mbeturinave ne baze te largësive ne kilometra e llojit te vendbanimeve

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Ne %
Urbane	3,596	-	-	-	-	3,596	33.9%
Para Urbane	-	952	-	-	-	952	9.0%
Rurale	-	-	1,282	2,673	-	3,955	37.3%
Rurale e Thell	-	-	-	-	2,108	2,108	19.9%
Total	3,596	952	1,282	2,673	2,108	10,611	100.0%
Ne %	33.9%	9.0%	12.1%	25.2%	19.9%		100.0%

2.7. Përlllogaritja e strukturës se mbeturinave ne baze te gjenerimit ditor për një person për vitin 2016 (ne ton)

Përbërja	Ne %	Total
Mbeturinat e kuzhinës	42.0%	4,457
Letra	13.6%	1,443
Tjera	11.5%	1,220
Plastika	10.6%	1,125
Hiri i nxemjes	8.3%	881
Gjami/shishet	4.9%	520
Bari & druri(mbetjet e gjelbërta)	2.9%	308
Hiri/dheu	2.9%	308
Metali	1.3%	138
Tekstili	1.2%	127
Qeramika & guri	0.5%	53
Goma dhe lëkura	0.3%	32
Totali	100.0%	10,612

Mbeturinat e përlllogaritura ne baze te gjenerimit ditor për një person ne dite.

- Urbane 0.62 KG
- Para Urbane 0.62 KG
- RURALE 0.50 KG
- RURALE e Thell 0.40 KG

2.8. Struktura e mbeturinave te përlogaritura për vitin 2016 e bazuar ne rangun e largësive te matura(ne ton)

Përbërja	Ne %	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Ne %
Mbeturinat e kuzhinës	42.0%	1,510	400	538	1,123	886	4,457	42.0%
Letra	13.6%	489	129	174	364	287	1,443	13.6%
Tjera	11.5%	414	109	147	307	242	1,220	11.5%
Plastika	10.6%	381	101	136	283	223	1,125	10.6%
Hiri i nxemjes	8.3%	298	79	106	222	175	881	8.3%
Gjami/shishet	4.9%	176	47	63	131	103	520	4.9%
Bari & druri(mbetjet e gjelbërta)	2.9%	104	28	37	78	61	308	2.9%
Hiri/dheu	2.9%	104	28	37	78	61	308	2.9%
Metali	1.3%	47	12	17	35	27	138	1.3%
Tekstili	1.2%	43	11	15	32	25	127	1.2%
Qeramika & guri	0.5%	18	5	6	13	11	53	0.5%
Goma dhe lëkura	0.3%	11	3	4	8	6	32	0.3%
Totali	100.0%	3,596	952	1,282	2,673	2,108	10,612	100.0%
Ne %		33.9%	9.0%	12.1%	25.2%	19.9%	100.0%	

2.9. Projektimi I mundësisë se mbledhjes se mbeturinave për periudhën 2016-2021 (ne ton)

Ndarja e mbeturinave ne % nga mbeturinat e gjeneruara			7%	8%	9%	10%	
Nr.	Përbërja	Ne %	2016	2017	2018	2019	2020
1	Mbeturinat e kuzhinës	42%	4,457	312	357	401	446
2	Letra	14%	1,443	101	115	130	144
3	Tjera	12%	1,220	85	98	110	122
4	Plastika	11%	1,125	79	90	101	112
5	Hiri i nxemjes	8%	881	62	70	79	88
6	Gjami/shishet	5%	520	36	42	47	52
7	Bari & druri(mbetjet e gjelbëria)	3%	308	22	25	28	31
8	Hiri/dheu	3%	308	22	25	28	31
9	Metali	1%	138	10	11	12	14
10	Tekstili	1%	127	9	10	11	13
11	Qeramika & guri	1%	53	4	4	5	5
12	Goma dhe lëkura	0%	32	2	3	3	3
	Totali	100%	10,611	743	849	955	1,061

Aneks III: Mbulimi i zonës me shërbime të MM

3.1. Shpërndarja ofrimit të shërbimeve të MM –Numri i ekonomive familjare

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Indeksi
-Ofrohen shërbimet e MM	3,072	792	1,050	1,870	1,359	8,143	93.9%
-Nuk-Ofrohen shërbimet e MM	-	-	42	199	293	533	6.1%
Total	3,072	792	1,092	2,069	1,652	8,676	100.0%
<i>Norma e Mbulimit</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>	<i>96.2%</i>	<i>90.4%</i>	<i>82.3%</i>	<i>93.9%</i>	

3.2. Shpërndarja ofrimit të shërbimeve të MM -Numri i popullatës

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Indeksi
-Ofrohen shërbimet e MM	15,892	4,205	6,754	13,241	11,883	51,975	92.5%
-Nuk-Ofrohen shërbimet e MM	-	-	269	1,406	2,558	4,233	7.5%
Total	15,892	4,205	7,023	14,647	14,441	56,208	100.0%

3.3. Përlllogaritja e indeksit të mbulimit me shërbime të MM (sipas largësive në KM)-numri i ekonomive familjare

-Ofrohen shërbimet e MM

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Ne %
Urbane	3,072	-	-	-	-	3,072	37.7%
Para Urbane	-	792	-	-	-	792	9.7%
Rurale	-	-	1,050	1,870	-	2,920	35.9%
Rurale e Thell	-	-	-	-	1,359	1,359	16.7%
Total	3,072	792	1,050	1,870	1,359	8,143	100.0%
<i>Ne %</i>	<i>37.7%</i>	<i>9.7%</i>	<i>12.9%</i>	<i>23.0%</i>	<i>16.7%</i>	<i>100.0%</i>	

-Nuk-Ofrohen shërbimet e MM

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Ne %
Urbane	-	-	-	-	-	-	0.0%
Para Urbane	-	-	-	-	-	-	0.0%
Rurale	-	-	42	199	-	240	45.1%
Rurale e Thell	-	-	-	-	293	293	54.9%
Total	-	-	42	199	293	533	100.0%
<i>Ne %</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>	<i>7.8%</i>	<i>37.3%</i>	<i>54.9%</i>	<i>100.0%</i>	
Total	3,072	792	1,092	2,069	1,652	8,676	

3.4. Përlllogaritja e indeksit të mbulimit me shërbime-Ekonomit Familjare- MM (sipas largësive në KM)-Kompanitë e MM

Kategoria	0-3	3-6	6-9	9-12	12-40	Total	Ne %
NJP "Ambienti"	3,072	631	655	1,136	248	5,742	70.5%
Ekodrinia	-	161	395	734	1,111	2,401	29.5%
Total	3,072	792	1,050	1,870	1,359	8,143	100.0%
Ne %	37.7%	9.7%	12.9%	23.0%	16.7%	100.0%	

Aneks IV: Implementimi i PLMM

4.Efektet financiarë te realizimit te planit për periudhën 2016-2021

4.1.Iplemetimi mbulimit te zonës për periudhën e PLMM -Kategoritë kryesore për periudhën 2016-2021


Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomitë Familjare	-	393	140	-	-	-	533
Nr. Lokalitetet	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banoreve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara(Ne TON)	-	352	87	-	-	-	439

4.1.6. Përlllogaritja e te hyrave -implementimi I MM 2016-2021

Kategorit	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomitë Familjare	-	393	140	-	-	-	533
Të hyrat e përlllogaritura në vit (Tarifa 4.5 EURO)	-	21,232	7,545	-	-	-	28,777
Të përjashtuar nga pagesa	20.0%	20.0%	20.0%	20.0%	20.0%	20.0%	
Ekonomitë Familjarë/Aktive	-	16,986	6,036	-	-	-	23,021
Te hyrat Vjetore	-	16,986	6,036	-	-	-	23,021

Total Te hyrat(Komul.)	-	16,986	23,021	23,021	23,021	23,021	
-------------------------------	----------	---------------	---------------	---------------	---------------	---------------	--

Përlllogaritja e te hyrave -implementimi I MM 2016-2021



4.Lokalitetet që disa nga familjet nuk janë të përfshira në sistemin e MM

Zona	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Ekonomi Famil.	Ekonomi Famil./Te Mbulura	Ekonomi Famil./Pa Mbulura	Gjen.Mbet.ne Vit-Ton	Mbet. Jo-te. Menaxh.	Koef.Mbul.ne %	Koef.Jo-Mbul.ne %
Nushpal	Zona 2	7	6-9	220	32	22	10	40	13	68.3%	31.7%
Senoc	Zona 2	7	6-9	687	101	69	32	125	39	68.6%	31.4%
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	808	162	60	102	147	93	37.1%	62.9%
Gexhë	Zona 2	12	9-12	660	165	68	97	120	71	41.2%	58.8%
Kaznik	Zona 2	13	12-40	164	24	8	16	24	16	33.3%	66.7%
Bratotin	Zona 2	21	12-40	396	58	24	34	58	34	41.4%	58.6%
Dabidol	Zona 2	21	12-40	799	138	36	102	117	86	26.1%	73.9%
Sarosh	Zona 2	23	12-40	6	2	1	1	1	0	50.0%	50.0%
Petkoviq	Zona 2	28	12-40	731	183	56	127	107	74	30.6%	69.4%
Mrasor	Zona 2	32	12-40	191	28	15	13	28	13	53.6%	46.4%
Total				4,662	892	359	533		439	40.3%	59.7%

4.2.Iplemetimi ekonomive familjare te pa përfshira ne sistemin e MM për periudhën e planit 2016-2021

Zona	Viti/Implemtimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Nushpal	2017		10					10
Senoc	2017		32					32
Polluzhë	2017		102					102
Gexhë	2017		97					97
Kaznik	2017		16					16
Bratotin	2017		34					34
Dabidol	2017		102					102
Sarosh	2017		1					1
Petkoviq	2018			126.75				127
Mrasor	2018			12.965				13
Total		-	393	140	-	-		533
Lokalitetet		-	8.00	2.00	-	-		

4.2.1. Iplemetimi ekonomive familjare te pa përfshira ne sistemin e MM për periudhën e planit 2016-2021-Bazuar ne zona

Zona	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Zona 1	-	-	-	-	-	-	-
Zona 2	-	393	140	-	-	-	533
Total	-	393	140	-	-	-	533

4.2.2..Iplemetimi ekonomive familjare te pa përfshira ne sistemin e MM për periudhën e planit 2016-2021-Bazuar ne rangun e largësive

Largesia	2016	2017	2018	2019	2020	2021
0-3	-	-	-	-	-	-
3-6	-	-	-	-	-	-
6-9	-	42	-	-	-	42
9-12	-	199	-	-	-	199
12-40	-	153	140	-	-	293
Total	-	393	140	-	-	533

Aneks V:Vleresimi i performaces financiare e operativ te sektorit te MM Komuna Rahovec

5.0. Sektori i MM për kategoritë kryesore

2015

Muaji	Te hyrat	Inkasimi	% Arkëtimi	Mbet. Mbledhura	Nr. Klientët (4.5 Euro)
Janar	28,932	16,583	57.3%	661.73	6,429
Shkurt	28,679	16,473	57.4%	617.53	6,373
Mars	28,944	14,959	51.7%	629.53	6,432
Prill	28,994	17,217	59.4%	637.93	6,443
Maj	29,179	14,709	50.4%	631.93	6,484
Qershor	29,639	20,292	68.5%	614.73	6,586
Korrik	30,269	18,815	62.2%	692.93	6,726
Gusht	30,507	17,978	58.9%	790.83	6,779
Shtator	30,246	19,639	64.9%	743.73	6,721
Tetor	29,507	21,978	74.5%	691.65	6,557
Nëntor	30,031	21,443	71.4%	673.79	6,674
Dhjetor	29,559	29,978	101.4%	656.09	6,569
Total	354,486	230,063	64.9%	8,042.44	


2016

Muaji	Te hyrat	Inkasimi	% Arkëtimi	Mbet. Mbledhura	Nr. Klientët (4.5 Euro)
Janar	30589	19145	62.6%	588.00	6,798
Shkurt	34642	19060.01	55.0%	553.20	7,698
Mars	41563	19076.24	45.9%	694.60	9,236
Total	106,794	57,281	53.6%	1,835.80	

5.1. Sektori i MM për kategoritë kryesore për kompanitë (Ekoregjioni /Ekodrinia) për vitin 2015


Muajt	Ekoregjioni	Ekodrinia	Total Sektori
Janar	18,128	10,804	28,932
Shkurt	17,875	10,804	28,679
Mars	18,140	10,804	28,944
Prill	18,190	10,804	28,994
Maj	18,375	10,804	29,179
Qershor	18,835	10,804	29,639
Korrik	19,465	10,804	30,269
Gusht	19,703	10,804	30,507
Shtator	19,442	10,804	30,246
Tetor	18,703	10,804	29,507
Nëntor	19,227	10,804	30,031
Dhjetor	18,755	10,804	29,559
Gjithsejtë	224,838	129,648	354,486

Graf 1:Paraqitja grafike e te hyrave te sektorit te MM për vitin 2015



5.2.Analiza krahasuese e te hyrave te sektorit te MM për tremujorin e par 2015/2016


Muaji	2015	2016	+/-
Janar	28,932	30,589	1,657
Shkurt	28,679	34,642	5,963
Mars	28,944	41,563	12,619
Total	86,555	106,794	20,239



5.3. Analiza krahasuese e te hyrave e sektorit te MM e bazuar ne tremujor për 2015/2016

Te Hyrat	Vlera.Fat.
Q1-2015	86,555
Q2-2015	87,812
Q3-2015	91,022
Q4-2015	89,097
Q1-2016	106,794

Graf 2: Analiza krahasuese e te hyrave e sektorit te MM e bazuar ne tremujor për 2015/2016



5.4.Perllogaritja e numrit te klientëve aktiv ne sektorin e MM (te hyrat /4.5 Euro) për vitin 2015/2016

2015

Muajt	Ekoregjioni	Ekodrinia	Total Sektori
Janar	4,316	2,572	6,889
Shkurt	4,256	2,572	6,828
Mars	4,319	2,572	6,891
Prill	4,331	2,572	6,903
Maj	4,375	2,572	6,947
Qershor	4,485	2,572	7,057
Korrik	4,635	2,572	7,207
Gusht	4,691	2,572	7,264
Shtator	4,629	2,572	7,201
Tetor	4,453	2,572	7,025
Nëntor	4,578	2,572	7,150
Dhjetor	4,465	2,572	7,038

2016

Muajt	Ekoregjioni	Ekodrinia	Total Sektori
Janar	4,397	2,401	6,798
Shkurt	5,297	2,401	7,698
Mars	6,835	2,401	9,236